# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7554 E shtunë 9 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Opinioni i Ditës

Nga VETON SURROI

**Halli i përbashkët i berberit tim në Prishtinë dhe i pronarit të lavazhit në Kavajë**



Nëse fillojnë negociatat në qershor, i tërë dhjetëvjetëshi i ardhshëm do të kalojë në mashtrim të ndërsjellë. Shqipëria do të përpiqet ta mashtrojë BE-në se nuk ...

Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga SPARTAK NGJELA

**Ja pse e takoi Donald Lu, Fatmir Xhafajn**

Ambasadori amerikan Donald Lu dje takoi në mënyrë ceremoniale, botërisht e me ngarkesë të plotë politike, ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Në fakt, kjo ...

Vijon në faqen 21



INTERVISTA/ Flet kreu i ALUIZNI-t

## Ndërtimet pa leje, Lame: Tri këshilla për të legalizuar apartamentet

Artan Lame: Gati lejet për 8200 banorë në Tiranë. 1/3 e pallateve në gjithë vendin janë me shkelje

ORNELA MANJANI

Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t në një intervistë ekskluzive për "Gazetën Shqiptare" bën të ditur tri këshillat për procedurat që duhet të ndjekin të gjithë pronarët që kanë apartamente për të legalizuar ...

Në faqet 2-3

KRIMI PRANE "DON BOSKOS" NE TIRANE, DESHMITARET: PAME TMERR ME SY

# VRET ISH-TE DASHUREN, PLUMB KOKES EDHE VETES

Xhafer Mata kishte braktisur gruan dhe djalin 1-vjeç për 19-vjeçaren. Vëllai i autorit: Vajzën e donte, ju errën sytë nga dashuria, ajo e tradhtoi



*(Në foto)* Policia në vendin e vrasjes. Xhafer Mata dhe Xhuljeta Çuni

Në faqen 7

QENDRA RAJONALE

**"Ish-militantët e ISIS në Shqipëri", sherr qeveri-opozitë. Mediu, apel Metës**

Në faqen 5

HISTORIA E ÇIFTIT ME 6 FEMIJE

**Horror në Durrës, burri vret gruan 40-vjeçare se nuk i hapi derën**

Në faqen 8

LISTA E TRETE

**10 mijë pronarët në Korçë, shqyrtimi nga ATP dhe procedurat për t'u njohur me ecurinë**

Në faqen 11

MARREVESHJA

**Kërkimet për të zhdukurit në komunizëm nisin nga Mali me Gropa**

Në faqen 22

GAZSJELLESI



**Rama: TAP rriti punësimin. Ministri italian: Projekt i kotë, e rishikojmë**

Në faqen 13

BLUE TOOTH Prapaskenat dhe të eliminuarit, kush janë 6 finalistët e show-t të njohur

## "Dancing with the stars", kush e fiton kupën?

*"Nxehet" Rike Roci. Jonida Shehu i kthehet ekranit. "Shpërthen" Luana Vjollca*

Prej tashmë dymbëdhjetë netësh, çdo të premte është shfaqur një ndër emisionet më të shikuar në Vizion Plus, "Dancing with the Stars Albania". Nata e parë nisi në mars ku u rikthyen më të mirët e gjashtë sezoneve më parë. Duke përmendur këtu: Soni Malaj, Rovena Dilo, Aulona Musta, Mariza Ikonomi, Diellza Kolgeci, Rike Roci, Amos Zaharia, Landi Forina, Viktor Zhusti, Kristi Popja dhe Niko Komani. Ndërkohë që në moderim ka qenë ish-misi i Shqipërisë, bukuroshja Almeda Abazi së bashku me moderatorin Rudi ...





Suplement

EKSKLUZIVE

FLET ARTAN LAME

Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, janë përfunduar 102 pallate në Tiranë, gati lejet për 8200 banorë

# Ndërtimet pa leje, Artan Lame: Tri këshilla për të legalizuar apartamentet

## Pallatet në të gjithë vendin, rreth 1/3 në shkelje të lejes. Pas Tiranës nis procesi për pallatet e braktisura në Shkodër, Durrës, Vlorë e Elbasan



Foto ilustruese

Ornela Manjani

*Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t në një intervistë ekskluzive për "Gazetën Shqiptare" bën të ditur tri këshillat për procedurat që duhet të ndjekin të gjithë pronarët që kanë apartamente për të legalizuar. Artan Lame bën të ditur se janë përfunduar procedurat për legalizimin e 102 pallate në Tiranë dhe janë gati lejet për 8200 banorë. Gjithashtu, Lame bën të ditur se pas legalizimit të pallateve të braktisura në Tiranë do të nisë procesi për pallatet e braktisura në Shkodër, Durrës, Vlorë e Elbasan.*

**Ju sapo keni nisur procesin e legalizimit për pallatet që kanë shkelur lejen e ndërtimit dhe rastet kur pronarët kanë braktisur objektin pa pajisur me dokumente qytetarët?**

Procesi i legalizimeve nuk përbën më lajm, unë këtë e konsideroj si gjë pozitive. Për të thënë një shifër mjafton t'i referohemi muajit maj, ku ky proces u mbyll me 3535 legalizime që do të thotë vetëm në 30 ditë mbi 3500 familje shqiptare legalizuan pronën. Kjo për ne është një gjë shumë e mirë. Futja në rutinën normale dhe jo mbajtja në shportë duke e zvarritur me vite. Ky është një nga sukseset më të prekshëm të kësaj qeverisje në aspekt shifrash jo thjesht legalizimi, por formalizimi i kësaj pjese të madhe të ekonomisë shqiptare.

Përtej kësaj dalin xhepa që nuk i kishte prekur askush, ishin të varrosura në harresë dhe në pingpongun e institucioneve, edhe këtyre ne po përpiqemi t'i japim zgjidhje. E kam fjalën këtu për ato që ne i quajmë në të folurën e përditshme pallatet



Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, Artan Lame

e braktisura nga ndërtuesit, por jo vetëm kjo tipologji edhe ato pallate për të cilët ndërtuesit nuk interesohen, sepse i kanë marrë paratë nga qytetarët, pallatet me shtesa në ndërtim që do të thotë ka marrë leje për 6 kate dhe ka bërë 8 kate, etj., etj. kemi edhe shumë kategori problematikash si këto. Ky është një xhep që ka filluar të krijohet që në vitet '93-'94 dhe deri më sot, duke u shtuar vit pas viti. Asnjë qeveri nuk ishte marrë me këtë problem, ne i identifikuam dhe qeveria Rama vitin e kaluar, në janar 2017, miratoi një Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) për procedurat e legalizimit të këtyre objekteve, sepse me legjislacionin që ekzistonte ato nuk mund të legalizoheshin. Nisëm kështu menjëherë procedurat dhe mblodhëm informacionin e nevojshëm për këtë kategori. Pallati më i vjetër i futur në proces legalizimi është ndërtuar më vitin 1994, plot një çerek shekulli. Imagjinoni sa e komplikuar është situata për këtë, janë të ngatërruara procedurat, është i ngatërruar historiku i firmave, dhe e si i legalizimit të pallateve të braktisura është ndoshta procedura më e komplikuar me të cilën haset administrata publike për shkak të historikut, ndryshimeve në legjislacion, transferimeve nga një pronar tek një pronar, për shkak të shumë bleresve të këtyre objekteve apo për shkak se në një pallat nuk ke të bësh me një person, por me 50-60-70 qytetarë që si e ka hallin njëri s'e ka tjetri. Ne u bëmë thirrje subjekteve, disa reaguan, disa jo dhe mosreagimi na çoi në hapin e radhës, duhet të merrnim një masë ekstreme, që do të thotë një listë me subjekte që nuk reagojnë, për të cilët i kërkojmë Bashkisë së Tiranës të mos i pajisë më me leje ndërtimi. Kjo gjë është edhe në vetë interesin e bashkisë, që të mos japë leje për pronarë që shkelin këtë leje apo braktisin objektin dhe, nga ana tjetër, të mos krijojmë një stok tjetër qytetarësh që do të kenë të njëjtin problem. Lista u publikua dhe pas asaj u ndodhëm përballë një surprize të jashtëzakonshme, nga njëra anë qytetarët që dyndeshin me kontakte duke thënë: shumë mirë, dhe, nga ana tjetër, shumë subjekte që filluan të na kontaktonin dhe thoshin se nuk e kishin marrë seriozisht, po interesoheshin të vepronin tani që u përballën me masat. Kjo na detyroi të bënim një shtyrje të afatit për t'u lënë mundësi subjekteve të vinin për nisje të praktikës së legalizimit dhe arritëm në fund të kësaj jave punë, ku u paraqiten 122 subjekte, të cilat atë që s'e kishin bërë në një vit e gjysmë, e bënë brenda një jave. Këto subjekte u hoqën nga lista paraprake dhe do të vijnë të bëjnë depozitimin e dosjeve dhe të ndjekin gjithë procesin. Qëllimi ynë nuk është as të bllokojmë kot ndërtues në bashki, as të nxjerrim kot subjekte në lista dhe as të marrim në qafë ndonjeri. Qëllimi ynë është: hajdeni subjekte, përfshihuni në proces se ne do të japim gjithë ndihmën tonë për ta kryer atë. Në fund të gjithë ata që përfitojnë janë vetë subjektet që mbyllin një kalvar të vjetër dhe, nga ana tjetër, qytetarët që kanë vite e vite që presin të marrin në dorë ligjërisht pronën për të cilën kanë paguar.

> **STOKU**
>
> Ky është një xhep që ka filluar të krijohet që në vitet '93-'94 dhe deri më sot, duke u shtuar vit pas viti. Asnjë qeveri nuk ishte marrë me këtë problem, ne i identifikuam dhe qeveria Rama vitin e kaluar, në janar 2017, miratoi një VKM.

**Gjatë këtij procesi çfarë duhet të bëjnë qytetarët?**

Problemi i raportit dhe i punës konkrete me qytetarët është dy llojesh. E para, nëse subjekti na përgjigjet është shumë e lehtë, sepse kur kemi të bëjmë me subjektin ndërtues me firmën e ndërtimit e thërrasim i kërkojmë lejen e ndërtimit, i kërkojmë projektin e pallatit, listat e banorëve që ua ka shitur. Në këtë rast plotësohet me informacion dosja e objektit që është për t'u legalizuar. Plotësimi i dokumentacionit është më i thjeshtë, bëhet legalizimi në emër të subjektit dhe më pas është subjekti që bën kalimin një pas një te qytetarët. Ky është rasti më i mirë dhe më i lirshmi në operim. Edhe ky rast ka problematikat e veta, sepse ndërtuesi mund të jetë në gjyq me pronarët e tokës pasi ata kërkojnë pjesë te shtesat që janë bërë, ndërkohë shtesën e ka marrë dikush tjetër, etj.. Kategoria tjetër kur subjekti nuk ekziston

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**





Foto ilustruese

është fshehur dhe rasti më ekstrem kur ndërtuesi ka vdekur, për një histori që shkon 24 vjet vjen radha që edhe njerëzit vdesin, uroj të ketë sa më pak, por ka. Në këto raste ne mundohemi me bashkinë për të marrë projektin, banorëve u kërkojmë nëse kanë ndonjë material që u ka mbetur, sepse është shumë e vështirë, pasi na duhet që gjithë projektin ta bëjmë ne nga fillimi. Imagjinojeni çfarë do të thotë një pallat me 10 kate, me nga 4 familje për kat, pra 40 familje dhe me 10 dyqane poshtë, me 50 parkime, për të cilin duhet të bësh projektin nga e para. Pra, punonjësit tanë duhet të shkojnë shtëpi me shtëpi, t'u hapet dera, të bëjmë matjet dhomë më dhomë dhe njëri e hap derën, dhe njëri thotë s'jam sot, hajde nesër, tjetri thotë e kam me qira, e pafund problematika si këto. Plus vështirësive të tjera që kanë të bëjmë me faktin se ligji me të drejtë kërkon që për çdo pallat që legalizohet edhe një raport për qëndrueshmërinë e objektit, pasi dikush do të mbajë përgjegjësi se ky objekt qëndron. Analiza strukturore e objektit kryhet nga një subjekt i licencuar që duhet paguar, për rastet kur është pronari paguan ai, për rastet kur nuk është paguajnë banorët, të cilët është shumë vështirë t'i bësh në një mendje të paguajnë pjesën që u takon. Shuma nuk është e madhe, por njëri thotë ia kam dhënë pronarit, tjetri thotë hajdeni në fund të procesit dhe kjo e bën më të vështirë. Kur u thua qytetarëve bëhuni bashkë dhe hajdeni ndiqeni, është shumë e vështirë, sepse thonë unë s'flas me vëllain, jo më me fqinjin. Por ka vetëm një zgjidhje, në rast se duam ta bëjmë këtë gjë mund ta bëjmë të gjithë bashkë, ne nga zyra se bëjmë dot legalizimin dhe as banorët nga shtëpia nuk e bëjnë dot, pra duhet të bashkëpunojmë shumë me njëri-tjetrin.

**Tri këshillat që keni ju për këtë proces?**

E para, subjekteve, ejani se do të keni gjithë mbështetjen tonë për ta përmbyllur këtë proces. E dyta, banorëve, bëhuni bashkë, aty ku nuk keni mundësi me subjektet, zgjidhni një administrator, zgjidhni një jurist që banon në pallat ose arkitekt dhe ngarkojeni të vijë të ndjekë procedurat me ne. E treta, kur është subjekti, por nuk vjen, ju detyrojeni të gjithë së bashku të përmbyllë procesin

**Sa pallate kanë përfunduar procesin deri tani?**

Duket shumë e vështirë, por mund të them se vjet në janar kur doli vendimi deri tani në fund të majit janë legalizuar 102 objekte të tilla vetëm në Tiranë, pra pallate nga 5-6 kate deri 10-12 kate, dhe ne quajmë pallat një objekt mbi 5 kate, kanë përfituar rreth 8200 apartamente, shtëpi, banimi, garazhe, pra është bërë një punë kolosale dhe mjafton kjo për të thënë që nuk është ëndërr, por një hap që funksionon dhe bashkërisht mund ta bëjmë që të funksionojë, siç duhet. Afërsisht mund të them sipas analizës së ALUIZNI-t, se rreth 1/3 e lejeve të ndërtimit për pallate ka probleme legalizimi, në të gjithë vendin. Ky është një eksperiment që po e bëjmë dhe po e kolaudojmë me Tiranën dhe për të vijuar më pas edhe në qytete të tjera të mëdha, si Shkodra, Durrësi, Fieri Elbasani dhe Vlora, të cilat kanë problematikë me pallatet, por thjesht i quaj të braktisura. Nuk kanë këtë peshë si Tirana, por kanë problematika. Një tjetër xhep që ne keni nisur të zgjidhim janë ndërtimet pa leje të institucioneve shtetërore. Janë me qindra institucione që kanë bërë ndërtime dhe prokurime pa leje, shtesa kati, shtesa anësore, gjithë godinën pa leje, të gjitha kanë problemin e legalizimit. Kur i kanë bërë s'kanë pyetur shumë, megjithëse ligji i urbanistikës ua ndalon. Kur dikush bën një ndërtim, duhet t'i shkojë policia ndërtimore t'i thotë ç'po ndërton ku e ke lejen, po thotë jam shtet dhe lëre të vazhdojë, është shkelje ligji. Ligji kërkon që prokurimet shtetërore që bëhen për ndërtime të jenë të shoqëruara me leje ndërtimi. Në momentin që fillon ndërtimin e një njësie, duhet patjetër leja. Tani kanë ngecur në procesin e legalizimit, ka institucione që kanë nisur dhe kanë bërë një punë, ka të tjera institucione që s'e kanë vënë ujin në zjarr. Mjafton të them këtë që QSUT-ja ka një mori ndërtime godinash të brendshme pa leje për të cilat është në proces me neve për t'i legalizuar. Drejtoria e Doganave që ishte gabimisht te lista e parë po bën procedurat për një shtesë që ka. Ndërkohë është një listë e pafund institucionesh që janë tërësisht në ajër dhe në një moment të dytë do t'i publikojmë.

## PROCESI

Ky është një eksperiment që po e bëjmë dhe po e kolaudojmë me Tiranën dhe për të vijuar më pas edhe në qytete të tjera të mëdha, si: Shkodra, Durrësi, Fieri Elbasani dhe Vlora, të cilat kanë problematikë me pallatet, por thjesht i quaj të braktisura.

**Ç'po ndodh në hipotekat z. Lame?**

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, unë do të preferoja termin Kadastra, dhe i gjithë sistemi është në një gjendje pranë katastrofës. Unë e kam thënë sa herë kam mundur këtë gjë dhe duhet të jemi të ndërgjegjshëm, qeverisja është përderisa e thotë, por duhet të bëhet edhe publiku për të kuptuar që i gjithë sistemi i pasurive të paluajtshme dhe sistemi hartografik i Republikës së Shqipërisë është në pragun e katastrofës për shkak të mbartjes së gabimeve dhe të keqmenaxhimit çerek shekullor. Mjafton të përmend këtu që sipas analizave tona dhe të Bankës Botërore rreth 80 % e pasurive të regjistruara janë me gabime.

**Çdo të thotë me gabime?**

Do të thotë që ka keq kufijtë, që pasuria është këtu e çojnë në një vend tjetër, që ka mbivendosje me një tjetër pasuri, që ka 7 gjyqe të pambyllura apo ka 4 vendimmarrje për një pronë të vetme. Për një pasuri të vetme është bërë edhe kthim prone, dhe ATMP, dhe legalizim, dhe privatizim dhe ajo rezulton një pasuri. Kanë vepruar kështu që të vjedhin të gjithë, të abuzojnë të gjithë, me vetëdije të mos harmonizohen gjërat dhe të bëjnë gjithë atë që duan. Dhe kjo bën më pas që të përplasen të gjithë më njëri-tjetrin dhe të shkojnë në gjykata, e cila thotë hajde këtu të të mat unë kokën për të peshuar se cili nga ju të katër do të marrë, e merr njëri dhe tre të tjerë hapin tri gjyqe prapa. Gjithë ky sistem i pasigurt, pra 80 % e regjistrimit është problematik, do të thotë që sistemi i kadastrës nuk rregullohet thjeshtë duke rregulluar fasadën e shërbimit. Unë e them me përgjegjshmëri që në 6 muajt e fundit kanë një përmirësim jashtë çdo imagjinate të nivelit të shërbimit, të respektimit të afateve për sa është e mundur, por problemi që ato ofrojnë është i gabuar. Pra, nuk zgjidhet kjo çështje thjesht duke rregulluar fasadën pa rregulluar të gjithë prapavijën. Hipoteka e sotme është një mulli i prishur që bluan grurë të mykur dhe prodhon miell të bluar keq dhe të mykur. Shite si të duash këtë produkt, por po shet një produkt që do të të sëmurë.

## HIPOTEKA

Për një pasuri të vetme është bërë edhe kthim prone, dhe ATMP, dhe legalizim, dhe privatizim dhe ajo rezulton një pasuri. Kanë vepruar kështu që të vjedhin të gjithë, të abuzojnë të gjithë, me vetëdije të mos harmonizohen gjërat dhe të bëjnë gjithë atë që duan.

**Cila mund të jetë zgjidhja?**

Duhet të rregullojmë jo vetëm banakun, duhet të rregullojmë mullirin dhe arën prapa. Duhet rregulluar gjithë hartografika nga fillimi dhe gjithë sistemi i operimit të Kadastrës. Kjo është një reformë kolosale, e cila është duke avancuar edhe nga pikëpamja formale ligjore, pra duke bërë gati legjislacionin, por edhe harmonizimi i të gjithë këtyre institucioneve për rakordimin me njëri-tjetrin. Thelbi i kësaj reforme është unifikimi dhe bashkimi i gjithë institucioneve që kanë të bëjnë me pronën në vend dhe mbyllja e proceseve legjendare të pronësimit në Shqipëri. Ka 20 e ca vjet që kthejmë prona dhe janë të gjithë të pakënaqur, ka 20 e ca vjet që ndajmë tokën dhe 12 vjet që legalizojmë, ka 20 e ca vjet që privatizojmë dhe ende nuk është mbyllur. Të gjitha këto procese duhet të ishin mbyllur për 3-4 vjet.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje programesh Software për nevojat e Bankës se Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3.581.600 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerje programesh Software për nevojat e Bankës se Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 04 Korrik 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

# NEGOCIATAT

## LOBIMI

Kreu i PD-së takon deputetët austriakë: Kërkova hapjen e negociatave për Shqipërinë

# Austria, Lopatka: Shqetësim çështja "Xhafaj", hetimi të jetë i besueshëm

## "Qytetarët tanë, të shqetësuar për krimin e organizuar"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, në prag të dhënies së vendimit nga Komisioni Europian për hapjen ose jo të negociatave me Shqipërinë kërkoi mbështetjen e Austrisë. Pas një takimi me zëvendëskryetarin e Komisionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes në parlamentin austriak, Michael Hammer dhe deputetin Reinhold Lopatka, Basha tha se pavarësisht problemeve të thella që po kalon vendi, hapja e negociatave do të rriste kontrollin ndaj qeverisë. Ligjvënësi austriak, Lopatka tha se Austria mbështet integrimin e Shqipërisë, por shtoi se lufta ndaj krimit të organizuar është thelbësore. Reinhold Lopatka, si kryetar i Komisionit parlamentar të Çështjeve Europiane në parlamentin austriak shprehu mbështetjen e vendit të tij për hapjen e negociatave, por nuk la pa përmendur çështjen më të nxehtë politike të javëve të fundit, atë të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. "Padyshim që në jemi pro hapjes së negociatave në Këshillin Europian në fund të qershorit. Megjithatë, më duhet të theksoj se jemi të shqetësuar për çështjen 'Xhafaj'. Rasti i ministrit Xhafaj duhet të hetohet në mënyrë të besueshme, në mënyrë që të mbështesë rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian. Qytetarët austriakë janë të shqetësuar përsa i përket krimit të organizuar", theksoi z. Lopatka. Dy ditë më parë Austria, Gjermania, Holanda dhe Danimarka i propozuan Brukselit si zgjidhje përfundimtare për refugjatët nga Lindja e Mesme ngritjen brenda këtij viti të një kampi të përhershëm azilkërkuesish në një nga shtetet e kontinentit europian, por jashtë kufijve të BE-së.

### KËRKESA

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha kërkoi që Austria të mbështesë hapjen e negociatave të vendit tonë me BE, ndërsa u shpreh se kjo duhet të ndodhë pavarësisht problemeve të thella që po kalon Shqipëria. Basha përmendi: "Ne si opozitë jemi të angazhuar për të dhënë kontributin tonë, nga ana tjetër kemi bërë fare të qartë që ashtu si në luftën kundër trafikut të drogës, trafikut të qenieve njerëzore, luftës kundër korrupsionit qeveritar, diferenca bëhet nga mungesa e vullnetit politik apo nga ekzistenca e vullnetit politik. Në emër të opozitës, në emër të Partisë Demokratike kam përsëritur qëndrimin tonë të qartë, të prerë duke u kërkuar miqve tanë të bëjnë gjithçka që negociatat për anëtarësim të hapen, ky vendim të merret në Këshillin Europian në fund të këtij muaji. Natyrisht, shqetësimet për gjendjen politike në vend mbeten, veçanërisht sa i përket kapjes së politikës, kapjes së pushtetit nga krimi, kapjes së drejtësisë nga pushteti dhe problemeve që kjo ka shkaktuar për shtetin ligjor, për shtetin e së drejtës dhe për ekonominë", deklaroi z.Basha. Por sipas tij, "pikërisht për këto arsye, duke mos e fshehur të vërtetën, iu kemi thënë miqve tanë austriakë që ne e dimë fare mirë se kemi probleme serioze, jemi të angazhuar si opozitë për t'i zgjidhur këto probleme, kemi nevojë për ndihmën austriake dhe ndihmën europiane për t'i zgjidhur këto probleme, ndaj kërkojmë hapjen e negociatave si një instrument presioni dhe kontrolli ndaj qeverisë, me qëllim që Shqipëria të përparojë në luftën kundër krimit të organizuar dhe drogës, në luftën kundër korrupsionit, në zhbërjen e kapjes së shtetit nga krimi dhe në një drejtësi të pavarur, e cila nuk i mbron, por i ndëshkon politikanët e lidhur me krimin dhe korrupsionin".



Kreu i opozitës, Lulzim Basha me dy deputetët austriak Michael Hammer dhe Reinhold Lopatka

### MBËSHTETJA

Dy deputetë austriakë nga radhët e Partisë Popullore të Kancelarit Kurz, Reinhold Lopatka dhe Michael Hammer takuan dje z.Basha, ndërsa në një prononcim për mediat, thanë se vendi i tyre është pro hapjes së negociatave me Shqipërinë. Deputeti Reinhold Lopatka shtoi se lufta ndaj krimit të organizuar është thelbësore dhe në këtë pikë përmendi edhe akuzat ndaj ministrit të Brendshëm.


Gajtë një mbledhjeje të Këshillit të Ministrave

### BUJAR NISHANI

Ish-presidenti Bujar Nishani deklaroi se shteti është futur në kolaps të plotë, ndërsa theksoi se deri tani nuk ka asnjë investim. Nishani tha se e vetmja para që lëvrohet me shumicë është valuta e huaj si produkt i trafikut të narkotikëve.

Ndreu: Shpifje pa fre, të sfidoj në çdo gjykatë

## Denoncimi te Berisha: Vëllai i Pjerin Ndreut fik radarët me urdhër të trafikantëve



Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një denoncim që ka të bëjë me fikjen e radarëve për llogari, sipas tij, të trafikantëve. Sipas kapitenit dixhital, fikja e radarit bëhet me urdhër të Paulin Ndreut, vëllait të deputetit të PS-së, Pjerin Ndreu. Sipas qytetarit dixhital, pak ditë më parë Ndreu është emëruar drejtor i përgjithshëm te Drejtoria Detare. "Radarët fiken dhe ndizen për llogari të trafikantëve me urdhër të Paulinit sa herë do Paulini dhe partia. I bëj thirrje prokurorit të ndalojë këtë maskara që po shkatërron administratën detare për të mbushur xhepat e tij dhe të Tauland Allkes. Situata është ku thërret qameti. Administrata detare nuk ka qenë në këtë situatë as në '97", shkruan qytetari tek Berisha. Por vëllai i deputetit të PS-së Pjerin Ndreu, Paulin Ndreu, i cili mban postin e drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë Detare reagoi pas akuzave të kryeministrit Sali Berisha, i cili denonconte se radarët fiken dhe ndizen për llogari të trafikantëve. Përmes një postimi në "Facebook", Paulin Ndreu shprehet se Berisha shpif për të larguar vëmendjen dhe se Drejtoria Detare nuk ka asnjë lidhje me radarët. Ai shpreh gatishmëri për ta sfiduar ish-kryeministrin në çdo gjykatë.

## Balla me deputetët austriakë: Po ndiqen penalisht gjyqtarë e prokurorë të niveleve të larta

Deputetët austriakë u takuan dje edhe me kryetarin e grupit parlamentar socialist, Taulant Balla. Sipas njoftimi për mediat, Balla i ka njohur homologët e tij me zhvillimet në vendin tonë, ndërsa ka vlerësuar reformën në drejtësi dhe rezultatet që po jep vetingu. "Dua t'ju informoj se procesi i vetingut në sistemin e drejtësisë po jep rezultate konkrete, duke përjashtuar nga sistemi dhe vendosur në ndjekje penale gjyqtarë dhe prokurorë të niveleve të larta, për pasuri të vendosura në mënyrë të paligjshme e të krijuara për shkak të korrupsionit 27-vjeçar në drejtësi. Pikërisht suksesi i vetingut dhe lufta pa kompromis kundër krimit e korrupsionit, reforma në administratën publike, roli i Shqipërisë në rajon dhe politika jonë e jashtme në harmoni të plotë me BE etj., janë kriteret e përmbushura mbi të cilat u bazua rekomandimi pro hapjes së negociatave nga Komisioni Europian për Shqipërinë", u shpreh z.Balla. Sipas tij, "Austria ka mbështetur fuqimisht hartimin dhe implementimin e Reformës në Drejtësi edhe me prezencën e vyer të ekspertëve austriakë.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

PASURIA NR. 8/58 + 1 - 4 , E LLOJIT 'APARTAMENT' , VOLUMI 3 , FAQJE 188, ZONA KADASTRALE 8370, ME SIPËRFAQJE 75 M2 , NË ADRESËN : RRUGA "TH.ZIKO, PALLATI 65 / 3, TIRANË, NË PRONËSI TË SHTETASVE : Z. ENGJELL TOPORE DHE ZNJ. NATASHA TOPORE".
**ÇMIMI 36.350 Euro . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 04.06.2018 deri në datën 04.07.2018 .**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

PASURIA NR. 101 / 8, E LLOJIT ' TRUALL + NDËRTESË ' , VOLUMI 8 , FAQJE 115, ZONA KADASTRALE 3096, ME SIPËRFAQJE 3.200 M2 , NGA TË CILAT 166 $M^2$ ËSHTË NDËRTESA, NË ADRESËN : QEREKË-KRUJË, NË PRONËSI TË SHTETASVE : Z. YAHIA FARWATI dhe BRIXHILDA FARWATI".

**ÇMIMI 114.508 Euro . Data e zhvillimit të ankandit do jetë në datën 04.07.2018 .**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

STRATI

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k.,** njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

**-"Arë" me sipërfaqe 3000 $m^2$, e ndodhur në Tiranë, Kashar, regjistruar në pronësi të Eduard Zadeja, me Nr. Pasurie 1152/36, Zona Kadastrale Nr. 2105, volumi 17, faqe 154, regjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluajtëshme Tiranë, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 321 Rep dhe Nr. 125 Kol datë 12.02.2007.** Çmimi fillestar i ankandit është **246,960 Euro.**
**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 18.06.2018.**
**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com**



Shqipëria ngre kamp për terroristët e ISIS? Basha: Karamele e Ramës për Europën!

# Qeveria: Qendër rajonale, jo grumbullim i ish-militantëve të ISIS-it

## *Lleshi: Si u keqpërdor fraza e kryeministrit të Bullgarisë*

Valentina Madani

Qeveria është vënë së fundmi përballë akuzave të forta të opozitës për ngritjen e një kampi rehabilitimi në Shqipëri për terroristët e ISIS. Por sipas kreut të PD-së, Lulzim Basha, ngritja e një kampi refugjatësh në Shqipëri është një vendim që nuk mund të merret nga një person i vetëm dhe sipas tij, kjo nuk duhet të serviret si një karamele për të ëmbëlsuar gojën e hidhur të Europës nga skandalet e Tahirit dhe Xhafajt. "Unë kam qenë në komunikim të vazhdueshëm, përfshi edhe kancelarin Kurz dhe të tjerë përfaqësues të qeverive perëndimore edhe mbi këtë problem. Shqetësimi sa i përket Shqipërisë dhe aktivizimit të ashtuquajturës rrugë ballkanike ka të bëjë me a është e aftë Shqipëria në këtë gjendje të shtetit ligjor, në këtë gjendje të luftës ndaj korrupsionit dhe krimit, që konsiderohet e pamjaftueshme të përballojë një krizë të tillë?! Ne si opozitë jemi të angazhuar për të dhënë kontributin tonë, nga ana tjetër kemi bërë fare të qartë që ashtu si në luftën kundër trafikut të drogës, trafikut të qenieve njerëzore, luftës kundër korrupsionit qeveritar, diferenca bëhet nga mungesa e vullnetit politik apo nga ekzistenca e vullnetit politik. Opozita, PD ka demonstruar katërcipërisht vullnetin politik për t'u përballur me të vërtetat, jo për t'i fshehur ato, as për të pretenduar që nuk ekzistojnë, ndërsa një qeveri e cila deri më dje mohonte krimin, drogën, në vlerësimin tonë nuk ka as besueshmëri, as vullnetin politik dhe as potencialin për të mobilizuar kapacitetet shtetërore. Ndaj, një dimension i tillë që kapërcen kufijtë e vendit tonë nuk mund të jetë një vendim i vetëm një personi, aq më pak nëse kjo serviret si karamele për të ëmbëlsuar gojën e hidhur të Europës nga skandalet 'Tahiri', 'Xhafaj' dhe lufta e pamjaftueshme kundër drogës dhe krimit", deklaroi z.Basha.

**REAGIMI**

Pas lajmeve që qarkulluan në media se në Shqipëri mund të ngrihej një qendër rehabilitimi për ish-terroristët e ISIS, reagoi Kryeministria duke e quajtur të pavërtetë. Përmes një deklarate për mediat, këshilltari i Sigurisë në Kryeministri, Sandër Lleshi, bën me dije se nuk ekziston asnjë lloj ideje, kërkese për diçka të tillë. Ai sqaroi se bëhet fjalë për Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, që ishte edhe organizatorja e konferencës ndërkombëtare të para pak ditëve, ku mori pjesë edhe kryeministri i Bullgarisë, Borisov. "Duke vënë re se disa lajme të rreme me karakter provokues dhe politik spekulojnë haptazi mbi një gjoja qendër për grumbullimin e ish-militantëve të ISIS-it në Shqipëri, këshilltari i sigurisë i kryeministrit, Sandër Lleshi, bën me dije se nuk ekziston asnjë lloj ideje, kërkese, plani apo mundësie për diçka të tillë. Këto opinione që i referohen një frazë të përdorur nga kryeministri Borisov janë krejt pa lidhje me subjektin, të cilit shefi i qeverisë bullgare iu referua në prononcimin e tij. Bëhet thjesht fjalë për Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, që ishte edhe organizatorja e konferencës ndërkombëtare të para pak ditëve, ku mori pjesë edhe kryeministri i Bullgarisë. Shqipëria ka propozuar kthimin e kësaj qendre në një qendër rajonale, për të kryer analiza, vlerësime, studime, shkëmbim informacioni si edhe programe të përbashkëta kundër ekstremizmit të dhunshëm. Por kjo qendër as nuk është, as nuk mund të jetë dhe as nuk i ka shkuar kurrkujt në mendje që të kthehet në një repart grumbullimi të ish-militantëve të ISIS-it. Jo vetëm sepse askush dhe asnjëherë nuk e ka kërkuar një gjë të tillë, po edhe sepse kjo fantazi nuk ka asgjëkund lidhje me misionin e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe me projektin tonë për rajonalizimin e saj", thuhet në reagimin e Kryeministrisë.

**LULZIM BASHA**

"Një dimension i tillë që kapërcen kufijtë e vendit tonë nuk mund të jetë një vendim i vetëm një personi, aq më pak nëse kjo serviret si karamele për të ëmbëlsuar gojën e hidhur të Europës nga skandalet 'Tahiri', Xhafaj dhe lufta e pamjaftueshme kundër drogës dhe krimit", deklaroi z.Basha.



Foto ilustruese

### Ish-militantët e ISIS në Shqipëri?

## Mediu: Kërcënim! Meta të mbledhë Këshillin e Sigurisë

Kryetari i Partisë Republikane, Fatmir Mediu, shprehet kundër ngritjes së një qendre për luftëtarët e huaj të ISIS në Shqipëri, duke deklaruar se siguria kombëtare është e rrezikuar si kurrë më parë. Duke renditur arsyet pse është kundër kësaj ideje, Mediu thotë se siguria kombëtare nuk është vetëm çështje e Edi Ramës apo qeverisë, por edhe e parlamentit dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Kreu i republikanëve thekson se Presidenti Meta duhet që urgjentisht të kërkojë të gjithë informacionin për këto lajme, qëndrime apo largqoftë vendime të Ramës. "Qeveria duhet të lërë aventurat për interesa momentale politike. Sot siguria jonë kombëtare është më e rrezikuar se kurdoherë. Gjeopolitika me Ballkan me rritjen e influencës ruse, shqetësimet për rritjen dhe kontrollin e Turqisë, (jo për interesa të partneritetit



strategjik, por të mirëfillta të kontrollit politik, siç shprehen liderët evropianë), aktivizimi i shërbimeve të Iranit edhe për shkak të MEK, trafiku i drogës dhe pastrimi i parave janë kërcënime serioze, me të cilat duhet të merremi seriozisht. Siguria kombëtare nuk është vetëm çështje e Edi Ramës apo qeverisë, ajo i takon parlamentit dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Presidenti Meta duhet që urgjentisht të kërkojë të gjithë informacionin për këto lajme, qëndrime apo largqoftë vendime të Ramës", tha z.Mediu.

**QEVERIA**

"Shqipëria ka propozuar kthimin e kësaj qendre në një qendër rajonale, për të kryer analiza, vlerësime, studime, shkëmbim informacioni si edhe programe të përbashkëta kundër ekstremizmit të dhunshëm. Por kjo qendër nuk mund të kthehet në një repart grumbullimi të ish-militantëve të ISIS-it".

## ISIS në Shqipëri? Vasili: Kryeministri e pranoi në konferencën me Borisovin

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, reagoi dje pas deklaratës nga Kryeministria në lidhje me ardhjen e luftëtarëve që kthehen nga ISIS. Vasili shkruan në "Facebook": "Pse bedelët e qeverisë gënjejnë trashë për qendrën e koordinimit të ish-ave të ISIS? Të thuash që kjo qeveri u çmend e tëra nuk është lajm. Është e qartë që të zënë në faj për qendrën e koordinimit të ish-luftëtarëve të ISIS Shqipëri, kanë filluar përkthimet nga shqipja në shqip. Këta janë kaq të trashë, sa po na tregojnë që ka dy gjuhe shqipe, një të qeverisë dhe një të popullit. E bukur fare kjo, kryeministrit tonë ia thotë në sy kryeministri bullgar dhe tani sqarimet nuk i jep ai vetë, që ishte 50 cm larg Borisovit, por i japin këta bedelët, se kryeministrit i është zënë goja dhe s'ia mban të flasë vetë. Për këta bedelët me shqipe të çale po ua vëmë prapë ta lexojnë ç'ka thënë z.Borisov, pasi me paturpësinë dhe marrinë e tyre duan ta ngatërrojnë edhe atë, lexojeni: 'Në Shqipëri do të bëhet një qendër koordinimi për luftëtarët që kthehen nga ISIS në territorin e Ballkanit', u shpreh kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, në konferencën e përbashkët për shtyp të mbajtur bashkë me kryeministrin Rama", deklaroi z.Vasili.

## PD, Shehu: Transparencë, sqarimi i Kryeministrisë i vonuar

Deputeti i PD, Tritan Shehu reagoi dje pas deklaratës së këshilltarit të Sigurisë në Kryeministri, Sandër Lleshi se në Shqipëri mund të ngrihet një qendër rehabilitimi për ish-terroristët e ISIS. Shehu shprehet se 'sqarimi' i këshilltarit të Kryeministrisë është i vonuar dhe se të tilla projekte reale apo dhe iluzive, me interesa madhore për vendin, nuk mund të mbahen në "terr" informativ, por duhet transparencë. "Në fakt është 'zakoni' i kësaj qeverie që për të tilla çështje të veprojnë në konspiracion, derisa plas... Cilado qoftë përgjigja e këshilltarit, për mua kjo çështje akoma nuk është plotësisht e qartë, kjo edhe për faktin se si u menaxhua deri më tani. Në këto kushte do të vazhdoj ta ndjek me shumë vëmendje në zhvillimet e ardhshme, edhe si nënkryetar i Komisionit parlamentar të Politikës së Jashtme", deklaroi deputeti i PD-së.

GAZETA SHQIPTARE

**Kryetarja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paralajmëron qeverinë e opozitën**

# Mulaj: Do të denoncoj ndërhyrjet politike e financiare në veting



Kryetarja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Natasha Mulaj deklaroi dje, se nuk do të lejojë ndërhyrje nga politika në procesin e vetingut të gjyqtarëve e prokurorëve. Gjatë ceremonisë së përurimit të mjediseve të reja të KPA, Mulaj tha: "Do të denoncoj pa ekuivok çdo ndërhyrje politike apo financiare në veting". "Drejtësia jonë ka çeduar shumë, duke rrëzuar besimin dhe respektin e opinionit publik, dhe kjo për shkak të individëve të korruptuar. Tani unë besoj se është koha dhe momenti që ata të japin llogari. Asnjë tolerim, asnjë cedim, asnjë selektivitet, dhe asnjë përjashtim, sentenca: Të gjithë të barabartë para ligjit duhet të funksionojë si e tillë dhe opinioni qytetar duhet të bindet që ne po bëjmë këtë. Ata, gjithashtu, duhet të mësojnë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën për ta, por jo vetëm kaq, ata duhet dhe të japin llogari",-u shpreh Mulaj, para të pranishmëve, mes të cilëve ishte edhe ambasadori i SHBA-së, Donald Lu. "Nuk ka drejtësi të cunguar. Duhet të jetë e thellë e plotë dhe të shihet si e tillë. Unë personalisht gjykoj se filtri i imët dhe funksional do të shërbejë si gur themeli për shëndoshjen e sistemit. Edhe nëse nga vetingu dalin vetëm pak të pastër në bregun tjetër, kjo është sërish mjaft e shëndetshme. Të qënit i pastër, i papërlyer dhe i painfluencueshëm nga politika dhe paraja është parakusht thelbësor për të hedhur bazat e forta të shëndoshjes së drejtësisë së sëmurë shqiptare. Ne po e operojmë drejtësinë e sëmurë shqiptare, por jemi të sigurtë se pas reanimacionit ajo do të jetë më e shëndetshme se kurrë", u shpreh ajo. Sipas kryetares së KPA-së, "një nga gangrenat e shumta të realitetit shqiptar është padyshim selektiviteti". "Unë personalisht nuk do të hezitoj për asnjë moment, të denoncoj pa doreza dhe pa ekuivok çdo ndërhyrje financiare apo politike në veting. Askush nuk mund të vërë në dyshim integritetin dhe vullnetin tonë. Ne jemi shërbëtorë të devotshëm të ligjit dhe të popullit"- theksoi Mulaj.

Ne ceremoni ishin ftuar dhe merrnin pjesë përveç trupës së vetingut edhe përfaqësuesit e ambasadave kryesore ne vend, të cilët kanë dhënë ndihmesën e tyre në reformën në drejtësi.

**DEKLARATA**
"Nuk ka drejtësi të cunguar. Duhet të jetë e thellë e plotë dhe të shihet si e tillë. Unë personalisht gjykoj se filtri i imët dhe funksional do të shërbejë si gur themeli për shëndoshjen e sistemit. Edhe nëse nga vetingu dalin vetëm pak të pastër në bregun tjetër, kjo është sërish mjaft e shëndetshme",-tha dje, Mulaj.

## Gazsjellësi, kryeministri: Të vendosur të maksimizojmë përfitimet

# Rama: Projekti TAP, mbi 70% e fuqisë punëtore janë vendas

## "Funksionimi i veprës kontribut për mjedisin në Europë"

Darina Tanushi





Kryeministri Edi Rama

Kryeministri Edi Rama vlerësoi dje, rolin që ka pasur projekti i gazsjellësit Trans Adriatik TAP për rritjen e punësimit në zonat ku ai kalon. Gjatë fjalës në ceremoninë me rastin e instalimit të turbokompresorëve në stacionin e kompresimit të TAP, në Fier, Rama tha se: "Ky stacion, që do të jetë gati për të filluar operimin tregtar në vitin 2020, pritet të arrijë gjatë këtij viti në më shumë se 250 punonjës, ndërkohë që janë mbi 100 vende të tjera pune që janë gjeneruar për kompanitë që bashkëpunojnë me projektin në Fier, në Tiranë, në Elbasan dhe në Korçë dhe që janë të domosdoshme për ecurinë e projektit". Vlen për t'u theksuar, tha Rama më tej, se mbi 70% e fuqisë punëtore është vendase. "Të gjithë ata që janë përfshirë në këtë operacion, siç dëshmojnë edhe vetë kompanitë shqiptare që kanë bashkëpunuar dhe bashkëpunojnë për ndërtimin e kësaj infrastrukture të pazakonshme, rriten kapacitetet profesionale dhe teknike dhe kompanitë përfitojnë një vlerë të shtuar nga kjo pikëpamje, ku dihet botërisht që ne kemi një nevojë vazhdimisht urgjente",-u shpreh ai. "Futja në funksionim e kësaj vepre do të jetë një kontribut jo i vogël edhe në të ardhmen mjedisore të vetë Europës. Nga ana tjetër, qeveria jonë është e vendosur që të maksimizojë të gjitha përfitimet nga ky projekt strategjik, duke mos u kufizuar thjesht në të qenit të vendit tonë një vendkalim i gazit të Kaspikut për në Europë. Për këtë arsye, ne kemi punuar paralelisht që në krye të herës dhe sot kemi Masterplanin Kombëtar për Gazin, një dokument gjithëpërfshirës objektivash dhe synimesh të përcaktuara, që rregullon të gjithë hartën e veprimeve për gazifikimin e vendit tonë",-u shpreh kryeministri. "Ne duam të ndajmë përfitimet e gazsjellësit me vendet e tjera të rajonit, si një mënyrë që fuqizon zhvillimin tonë ekonomik, por fuqizon edhe zhvillimin e integruar dhe qëndrueshmërinë politike në Ballkanin Perëndimor. E në këtë aspekt janë dy projekte për të cilat ne kemi nisur të flasim, të diskutojmë, të nxisim investitorë të interesuar",-sqaroi Rama. Përmes gazsjellësit TransAdriatik, Shqipëria vendoset në një prej arterieve më të rëndësishme strategjike nga pikëpamja e energjisë sot në Europë. Avantazhet e kalimit të gazsjellësit në territorin tonë janë të shumta, vlerësoi kryeministri. "Dua ta theksoj që jam vërtetë krenar për faktin se, kur kemi nisur këtë punë, nga ana e palës që financon dhe administron këtë projekt na është shprehur shqetësimi se mos vallë Shqipëria kthehej në një pengesë për shkak të burokracisë dhe për shkak të problematikave në marrëdhëniet mes kompanisë dhe administratës. Sot, tanimë prej disa kohësh, pala që investon dhe administron projektin e ka thënë dhe e shpreh në mënyrë të përsëritur, që Shqipëria ka qenë një surprizë, pasi nuk ka pasur asnjë lloj pengese apo vonese nga pikëpamja e marrëdhënieve administrative, për asnjë lloj arsyeje, për lejet e të gjitha natyrave, për procedurat e të gjitha natyrave, shpeshherë komplekse, në ndonjë rast edhe në marrëdhënie potencialisht të vështira me komunitete të ndryshme",-u shpreh Rama.

**SHKARKIMI**
Kryeministri Edi Rama liroi dje, nga detyra zëvendësministren për Europën dhe Punët e Jashtme, Kleopatra Maliqi. Vendimi u publikua dje, në Fletoren Zyrtare. Burimet bënë të ditur se ajo është emëruar drejtoreshë e Shkollës së Administratës Publike.

## Italia do të rishikojë projektin TAP, ministri Costa: Vepër e kotë

Projekti i gazsjellësit TAP që brenda vitit 2020 parashikon të sjellë gaz nga Azerbajxhani në Europë është një vepër e kotë". Kështu ka deklaruar dje, ministri italian i sapo zgjedhur i ambientit Sergio Costa. Në një intervistë të dhënë për agjencinë e lajmeve 'Reuters', ministri Costa sqaron pozicionin e dikasterit që ai përfaqëson ndaj këtij mega projekti i konsideruar "strategjik" nga qeveritë e mëparshme italiane. "Rishikimi i projektit TAP është parashikuar nga kontrata qeverisëse e nënshkruar mes Lëvizjes 5 Yje e Lidhjes", ka informuar ministri italian i ambientit. Duke parë se konsumi i gazit është gjithnjë e në ulje në Itali, sot kjo vepër është e kotë",-tha ai. "Dosja e projektit TAP është mbi tavolinë e do ta trajtojmë me prioritet", është shprehur ai. Ministri Sergio Costa i ka kërkuar parlamentarëve të 5 Yjeve që prezantojnë rajonin e Puglias, në të cilin pritet të kalojë dhe gazsjellësi, dokumentacionin që vërteton impaktin negativ që kjo vepër ka në këtë territor. Rishikimi i projektit të këtij gazsjellësi deri në anulimin e tij nga ana e qeverisë Conte do të sjellë dhe rikonfigurimin e marrëveshjeve ndër qeverisëse me Greqinë e Shqipërisë, ku ky projekt është drejt përfundimit.



## Meta pret gjimnazistë e mësues nga Rahoveci: Ruaj kujtime mbresëlënëse

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti dje, në presidencë 30 gjimnazistë dhe mësues nga Krusha e Madhe e Rahovecit. Përmes një postimi në 'Facebook', Meta u shpreh se Krusha e Madhe e Rahovecit përjetoi një nga masakrat më çnjerëzore që u martirizua në emër të lirisë e pavarësisë së Kosovës dhe se ai ruan kujtime mbresëlënëse nga vizita e dy viteve më parë në shkollën e tyre. "Ende ruaj kujtime mbresëlënëse nga vizita ime e dy viteve më parë në shkollën e tyre që mban emrin e ndritur "Ukshin Hoti" dhe ndihem shumë i lumtur që sot këta të rinj e të reja, me rezultate të shkëlqyera në mësime janë miqtë e mi. Bashkëpunimi i të rinjve të ditur do t'i japë mundësi më të mëdha për zhvillim vendeve tona dhe kombit tonë",-u shpreh presidenti.




Skena e krimit





## Dëshmitarët: Pamë tmerr me sy, pas krimit Xhaferr Mata qëlloi veten me plumb në kokë

# 31-vjeçari vrau ish-të dashurën e më pas veten, vëllai i autorit: Vajza e tradhtoi

## *"Nga dashuria iu errën sytë, për 19-vjeçaren braktisi gruan dhe shkatërroi familjen"*

Ina Allkanjari

Një krim i kryer gjatë stresit të pasionit, pa mundësi reflektimi, ka tronditur mëngjesin e djeshëm kryeqytetin. Një 31-vjeçar ka qëlluar me armë zjarri vajzën që donte dhe më pas veten. Ngjarja ka ndodhur pak metra larg kishës së Don Boskos, ku Xhaferr Mata ka vrarë me dy plumba pistolete ish të dashurën, 19-vjeçaren Xhuljeta Çuni dhe më pas ka qëlluar edhe veten, duke ndërruar jetë një orë më vonë në spital.

31-vjeçari nga Kukësi, me profesion inxhinier i është afruar vajzës teksa ecte në zonën e "Don Boskos" dhe sipas dëshmitarëve okular, përpara se djali të kryente aktin makabër, ka debatuar me 19-vjeçaren. Pas sherrit, i cili mësohet të ketë zgjatur pak sekonda vajza ka tentuar të largohet, por Mata ka qëlluar me pistoletë dy herë drejt Xhuljetës, duke e lënë të vdekur. Dyshohet se mes 31-vjeçarit dhe Xhuljeta Çunit ka pasur një lidhje intime që më pas është ndërprerë nga e reja, çka ka sjellë dhe irritimin e Xhafer Matës.

Në lidhje me këtë ngjarje tragjike, ka reaguar për "Gazeta Shqiptare", vëllai i autorit. I tronditur për gjithçka kish ndodhur, ai tregon me dhimbje se ngjarja e rëndë ishte ende e pabesueshme për të. "Nuk e shpjegoj dot pse arriti deri në këtë pikë. E dija që e donte shumë vajzën. Nga dashuria madhe iu errën sytë. Braktisi gruan për vajzën që donte, dhe e reja e tradhtoi. Ende nuk e besoj që gjërat shkuan kështu. La jetim fëmijën 1 vjeç, - shpreh për 'GSH' vëllai i Xhaferr Matës. I pyetur se çdo të ndodhë me djalin e mitur ai u shpreh me lot në sy se fëmijën do ta rriste familja e Xhaferit. "Djali jeton me ne, kur u divorcua më gruan, fëmijën e mbajti Xhaferri. Ish-gruaja u kthye te njerëzit e vet, dhe djalin ia la vëllait. Fëmijën do ta rrisim ne",-u shpreh me dhimbje vëllai i 31-vjeçarit. Një i afërm, i cili ndodhej në banesën e autorit tregon për të shkuarën e Xhaferit. "U divorcua në dhjetor nga gruaja, mësuam se kishte një lidhje dashurie me 19-vjeçaren. Jemi të pushtuar nga dhimbja me tragjedinë që ndodhi, akoma nuk mund ta besojmë. Ishim në dijeni që Xhaferri e donte vajzën. Ishte shumë i qetë, punëtor dhe aspak problematik. Nuk e shpjegojmë dot këtë që ndodhi",-u shpreh një i afërm i Xhaferit.

Banorë të lagjes ku banonte i riu, të tronditur nga lajmi e përshkruajnë 31-vjeçarin si djalë pa probleme dhe person që nuk përfshihej në konflikte. "Kanë ardhur familjarisht para shumë vitesh në këtë lagje. Xhaferri ishte djalë i urtë, dhe asnjëherë nuk ka hapur probleme në lagje. Kishte mbaruar shkollën për inxhinieri mekanike, madje u diplomua këto muajt e fundit. Ishte shumë djalë punëtorë, ka një servis makinash dhe punonte për orë të tëra. Jemi të tronditur me ngjarjen", u shpreh një i moshuar, i cili banonte pranë shtëpisë së 31-vjeçarit.


Viktima Xhuljeta Çuni


Autori Xhafer Mata

**VËLLAI I AUTORIT**

Në lidhje me këtë ngjarje tragjike, ka reaguar për "Gazeta Shqiptare", vëllai i autorit. I tronditur për gjithçka kish ndodhur, ai tregon me dhimbje se ngjarja e rëndë ishte ende e pabesueshme për të. "Nuk e shpjegoj dot pse arriti deri në këtë pikë. E dija që e donte shumë vajzën. Nga dashuria madhe iu errën sytë. Braktisi gruan për vajzën që donte, dhe e reja e tradhtoi. Ende nuk e besoj që gjërat shkuan kështu. La jetim fëmijën 1 vjeç, u shpreh vëllai i Xhafer Matës.

**BANORET**

"Kanë ardhur familjarisht para shumë vitesh në këtë lagje. Xhaferi ishte djalë i urtë, dhe asnjëherë nuk ka hapur probleme në lagje. Kishte mbaruar shkollën për inxhinieri mekanike, madje u diplomua këto muajt e fundit. Ishte shumë djalë punëtorë, ka një servis makinash dhe punonte për orë të tëra. Jemi të tronditur me ngjarjen", u shpreh një i moshuar, i cili banonte pranë shtëpisë së 31-vjeçarit.

### DINAMIKA E NGJARJES

Më datë 08.06.2018, rreth orës 08:10, në zonën e Don Boskos, në rrugën "Eshref Frasheri", Xhafer Mata vrau ish-të dashurën e tij vetëm 19 vjeçe dhe më pas qëlloi mbi veten. Edhe pse u transportua menjëherë në spital ai ndërroi jetë. Vrasja ka ndodhur përpara një bar-kafeje dhe një furre buke, ndërsa dëshmitarët e shumtë janë terrorizuar nga ajo që panë. Sipas dëshmitarëve Xhafer Mata, është parë pak para krimit teksa bënte lëvizje kaotike në trotuar. Ai priste të kalonte Xhuljeta, vajza që donte e me të cilën dyshohet të ketë pasur një lidhje intime. Mësohet se fillimisht Mata e ka ndaluar në rrugë dhe ajo i ka kërkuar të mos e prekë. Sipas dëshmitarëve i riu i bërtiste vajzës duke e akuzuar se e ka ndarë nga familja e tij. "Më ndave nga familja, më ndave nga fëmija. Më ndave nga njerëzit e mi, më shkatërrove jetën. Pse ma bëre këtë"? Mësohet se i ka thënë Xhaferi Xhuljetës. Mësohet se pasi kanë debatuar për disa minuta vajza i ka kthyer shpinën dhe ai e ka qëlluar me një plumb. Ajo është rrëzuar në tokë ka nisur të kërkojë ndihmë, kalimtarët janë afruar, por ai iu ka drejtuar pistoletën, duke i zmbrapsur e duke iu thënë të mos kishin frikë pasi nuk do t'ju bënte gjë atyre. Gjithçka ka ndodhur në pak sekonda. Kur ka parë vajzën të lëvizte e të kërkonte ndihmë, ai i është afruar sërish dhe e ka qëlluar në fytyrë. Xhuljeta Çuni nga fshati Vinjoll i Matit, nuk mundi t'u mbijetonte plagëve dhe pas goditjes së dytë, gjeti vdekjen e menjëhershme. 31-vjeçari nga Kukësi pasi është siguruar se e ka vrarë ka vazhduar lëvizjet kaotike me pistoletë në dorë. Një grua i është drejtuar duke e pyetur se përse e vrau, ndërsa Xhafer Mata është përgjigjur i qetë "Mirë ia bëra që e vrava". Pak pas ngjarjes është parë të largohet me hapa të ngadaltë, është ulur afër një peme disa metra më tutje dhe ka nisur të qajë. Në momentin që policia ka mbërritur në vendngjarje, Xhaferri ka qëlluar veten me një plumb në kokë, ndërsa një orë pas ngjarjes ka ndërruar jetë në spital.

> **DËSHMITARËT**
> Sipas dëshmitarëve i riu i bërtiste vajzës duke e akuzuar se e ka ndarë nga familja e tij. "Më ndave nga familja, më ndave nga fëmija. Më ndave nga njerëzit e mi, më shkatërrove jetën. Pse ma bëre këtë"? Mësohet se i ka thënë Xhaferri Xhuljetës.

Ai nuk ka mundur t'i mbijetojë plagës së rëndë të shkaktuar nga një plumb në kokë ndonëse u transportua menjëherë pranë Qendrës Spitalore të Traumës. Ka qenë e pamundur madje të ndërhyhej nga mjekët për të hequr plumbin për shkak të dëmtimit shumë të madh. Mjekët e kanë klasifikuar si një rast terminal që në mbërritjen e tij në spital. Mësohet se Xhafer Mata ishte divorcuar në dhjetor të vitit 2017, ndërsa kishte një djalë 1 vjeç. Ndërkohë fëmijën e mbante ai bashkë me prindërit e tij. Mata kishte krijuar një lidhje jashtëmartesore me Xhuljetën, marrëdhënie që çoi edhe në divorc. Pavarësisht se hoqi dorë nga martesa e tij, lidhja me Xhuljetën zgjati vetëm 6 muaj. Po ashtu mësohet se vajza punonte në një supermarket afër banesës së djalit.

"Bëra hatanë, nuk dua të besoj se 6 fëmijët e mi mbetën pa nënë"

# Krimi në familje trondit Durrësin, burri vret gruan gruan se nuk hapi derën

## Çlirim Shaholli: E shtyva, ra me kokë në dysheme

Klodiana Haxhiaj

**DURRES**

Krimi në familje trondit Durrësin. Një 42-vjeçar ka vrarë gruan e tij pas një sherri banal. Ngjarja e rëndë ku humbi jetën Ana Shaholli ndodhi mbrëmë në lagjen nr.15 (zonën e ish-Kënetës) të këtij qyteti. Mësohet se 40-vjeçarja, nënë e 6 fëmijëve, dha shpirt në spitalin rajonal të Durrësit për shkak të goditjes që kishte marrë në kokë. Ndërkohë, ka përfunduar në pranga autori i dyshuar i krimit, Çlirim Shaholli. Ka qenë 42-vjeçari që ka dërguar bashkëshorten në spital. Pas sinjalizimit për vdekjen e shtetases në fjalë, policia ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje që ka shokuar banorët e qytetit bregdetar. Pas kryerjes së hetimeve paraprake, dyshohet që ngjarja ka ndodhur në sherr e sipër mes bashkëshortëve Shaholli. Ndërkaq, gjatë marrjes në pyetje, Çlirim Shaholli ka deklaruar se nuk donte të vriste gruan dhe nuk e beson se ajo ka vdekur. "Ajo që ndodhi është shumë e rëndë. Nuk dua ta besoj se ime shoqe nuk është më dhe se fëmijët e mi kanë mbetur pa nënë", -ka thënë 42-vjeçari.


Syrja Hysenllari, duke folur për "GSH"

**RRËFIMI I KUSHËRIT**

"Ishim në punë kur e mësuam lajmin e kobshëm. U tmerruam se nuk e mendonim se Çlirimi do vriste Anën. Nuk kishim dijeni se ata kishin konflikte. Ai s'kishte asnjë motiv që t'i merrte jetën nënës së 6 fëmijëve të tij",-u shpreh kushëriri dhe njëkohësisht fqinji i 42-vjeçarit vrasës, Syrja Hysenllari.

**NGJARJA**

Burime zyrtare nga policia e Durrësit bënë me dije se rreth orës 19:55 të së premtes, në urgjencën e Spitalit Rajonal Durrës ka shkuar e lënduar në kokë dhe ka ndërruar jetë shtetësia A. Sh. 40 vjeçe banuese në lagjen nr. 15. "Nga hetimet e kryera ka rezultuar se autor i dyshuar është bashkëshorti i saj, shtetasi Ç.Sh. 42 vjeç, i cili e ka goditur me mjete të forta. Shtetasi i mësipërm është shoqëruar në ambientet e policisë Durrës, i cili po pyetet mbi rrethanat e ngjarjes",-thuhej në njoftimin paraprak të policisë. Por, pas autopsisë ka rezultuar se Ana Shaholli ka vdekur për shkak të një plage në kokë që mund të jetë shkaktuar si pasojë e rrëzimit në tokë. "Viktima është futur direkt në sallën e kirurgjisë. Pavarësisht ndihmës së dhënë, ajo nuk mundi të mbijetonte. Gruaja ka një goditje në kokë që nuk është shkaktuar me mjete prerëse, por mund të jetë shkaktuar si pasojë e rrëzimit në tokë", pohuan për "GSH", burime nga spitali i Durrësit. Ndërkohë, autori i dyshuar i krimit brenda familjes ka dhënë dëshminë e tij para bluve, duke sqaruar se gjatë sherrit ai e shtyu gruan dhe ajo u rrëzua me kokë në çimento.

**DËSHMIA E BURRIT TË VIKTIMËS**

"Nuk doja ta vrisja gruan. Nuk e besoj se ajo ka vdekur. Është gjë shumë e rëndë për familjen tonë dhe për fëmijët tanë të mitur. Ne u zumë. Ajo më shtyu dhe unë e shtyva. Nuk e mbaj mend mirë se si nisi sherri, por më duket se u grindëm për derën, jo hape ti jo hape ti, pasi ishte shumë vapë. Fëmijët nuk ishin në banesë, pasi po luanin jashtë. Mbaj mend se e shtyva dhe ajo ra me kokë në çimento. E mora në krahë dhe e çova në spital. Nuk dua ta besoj që fëmijët e mi kanë mbetur pa nënë. Ndodhi hataja",-ka deklaruar gjatë marrjes në pyetje, i arrestuari Çlirim Shaholli. Mësohet se familja Shaholli, me origjinë nga fshatrat e Korçës, por banues prej disa vitesh në Durrës jetonin në varfëri ekstreme.

**FAMILJARËT**

Të afërm të familjes Shaholli thanë se janë tmerruar nga vrasja e 40-vjeçares. Ata pohuan se familja prej 8 anëtarësh mbahej me rrogën e viktimës, e cila punonte në një lavanderi. Ndërsa, i shoqi ishte i papunë. "Ishim në punë kur e mësuam lajmin e kobshëm. U tmerruam se nuk e mendonim se Çlirimi do vriste Anën. Nuk kishim dijeni se ata kishin konflikte. Ai s'kishte asnjë motiv që t'i merrte jetën nënës së 6 fëmijëve të tij",-u shpreh kushëriri dhe njëkohësisht fqinji i 42-vjeçarit vrasës, Syrja Hysenllari.


## REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST
**(CONSULTANING COMPANY)**

**ALBANIA**
*CITIZEN – CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT*
Loan Agreement Project ID No. 8521

Posted 07.06.2018

Assignment Title: **Conducting the Midterm Assessment – Household Survey**

Ref. No: **ALB-8521/CS/CQ/3.11.01**

Under the Innovative Good Governance priority, launched in April 2014, the Program "Innovation against Corruption: Building a Citizen Centric Service Delivery Model in Albania continues under the supervision of the Deputy Prime Minister's Office. The program entails a multilayered reform that focuses on key administrative central government public services to reduce the time and burden for citizens and businesses and improve service delivery quality, transparency and efficiency by using innovative solutions and information technologies. Its key pillars are (i) the establishment and management of an integrated nationwide model of service delivery whereby, the front office is focused on the relation with the public and is separated from back office processing, including the implementation of the one-stop-shop and in-one-place approach of the Citizen Service Center; (ii) service provision standardization, simplification through business process re-engineering and digitization, with a focus on online services; and (iii) citizen feedback and performance monitoring on service delivery for ongoing improvement.

ADISA has taken several steps by first standardizing the information on public services and making such information available in multiple platforms, both digital and non-digital in order to reach all population categories. Such platforms include a dedicated line 118 00 (Call Center service), operational for inbound calls since October 2016, the One Stop Shop Centers where a dedicated desk is set for providing information to anyone who visit them, the e-Albania portal and ADISA's website.

A baseline assessment survey was conducted in the first half of 2016, producing baseline data on several indicators, in order to measure progress toward project's objectives.

As part of the effort to monitor the effectiveness of these interventions, ADISA is seeking the services of a firm/Consultant to conduct a midterm assessment to measure project progress. It consists of conducting a nationally representative household survey, intended to yield data on citizen access to public services, citizen satisfaction with public services, use of e-government, and channels for service delivery and information, etc. The information collected through the HH survey will supply data on specific project indicators regarding Access to administrative services in Albania, particularly the access to services of the vulnerable groups (including Roma), poor, female, etc.,

The Project Management Unit now invite eligible "Consultant" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The Consultant shall possess and be able to prove the following qualifications, experience, skills and competencies:

- No less than 10 (ten) years of general experience in surveying is required, with special reference to nationwide household surveys.
- At least 2 similar contracts successfully carried out within the last 5 (five) years with certificates of satisfaction issued by the employers.

- Key staff with necessary qualifications and experience to run and manage and the assigned tasks. These include:
- Team Leader, who plans, supervises and manages the entire assignment, both the HH survey, with the assistance of the field and data managers and data analysts. S/he is responsible for the reporting to the beneficiary. Requirements comprise at least ten years of experience in managing and conducting related development assessment surveys, evaluations, and field research, including significant experience conducting large-scale, complex, mixed-method studies, data analyses, and producing high quality written reports. Should possess degree in management, economics, or other relevant field, and specific training/experience in survey management and data analysis.
- 1 Project coordinator, responsible for daily coordination and management of project activities, resources, equipment and information. He/she is the liaison between the team leader and the rest of the staff. Project coordinator must possess demonstrated experience as project coordinator, with proven experience in managing large scale quantitative surveys. Should possess degree in management, economics, or other relevant field, and specific training/ experience in survey management.
- 3 Field Managers responsible for training of field staff in charge for carrying out the face to face household assessment, which plan, supervise and manage the field work. The Field Managers must have experience in managing field work of large-scale household surveys of over 1000 households; have degree in management, or other relevant field, and specific training in survey management. They must be familiar with the use of the CAPI.
- 1 Data Analysts/manager, who plans, supervises and manages data entry, error checking, processing and consolidation of data; has solid skills in both quantitative and qualitative analysis including professional and frequent application of quantitative analysis software such as SPSS, STATA, or equivalent applications. The data analyst/manager must have experience in managing data entry of large-scale household surveys of over 1000 households; degree in statistics or other relevant discipline; specific training in household survey management and data analysis, and specific training and experience in using CAPI.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualifications method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The notification is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): www.adisa.gov.al.

Expressions of interest (CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by **June 21, 2018**, at **12.00 local time**

**Project Management Unit**
**Blvd: Zhan d'Ark,**
**Ish shtepia e oficerave, Kati V-te**
**Tirana, Albania**
**E-mail: roland.larashi@inovacioni.gov.al;**
**and ccsdprojectalbania@gmail.com**

I riu dërgohet në spital, i japin qetësues. Shtrohet edhe e motra 14 vjeçe, në gjendje shoku

# Vrau nënën dhe babain me kallashnikov, Qemal Sela "çmendet" në paraburgim

## 26-vjeçari i bie murit me kokë: Po vijnë persona me maska të më bëjnë vaksina

DIBËR

Një ditë pas krimit të dyfishtë që tronditi Peshkopinë dhe mbarë opinionin publik, gjendja psikologjike e 26-vjeçarit Qemal Sela, i cili zbrazi një karikator kallashnikovi mbi nënën dhe babain është rënduar më shumë. Burime zyrtare nga policia e Dibrës bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se autori i krimit të dyfishtë është dërguar paraditen e djeshme në spitalin e Peshkopisë, ku i janë bërë qetësues. Mësohet që i riu, i cili vrau prindërit vetëm pak orë pasi u kthye nga Anglia ku kishte emigruar prej disa vitesh është në gjendje shoku, flet përçart dhe bën veprime të pakontrolluara. Sipas bluve, Sela që aktualisht ndodhet në paraburgimin e komisariatit të Dibrës i bie murit me kokë. "Po vijnë persona të maskuar të më bëjnë vaksina", përsërit herë pas here ai. Sjellja e çuditshme e 26-vjeçarit ka shtuar më shumë misterin rreth ngjarjes tragjike të ndodhur mesditën e së enjtes në lagjen "Llixha" të qytetit të Peshkopisë, ku humbën jetën bashkëshortët Flamur dhe Zeqimete Sela, përkatësisht 55 dhe 50 vjeç. Kjo për faktin se nga njëra anë dyshohet që autori i krimit brenda familjes vuan nga probleme mendore, ndërsa nga ana tjetër dyshohet se ngjarja ka marrë shkas nga një konflikt për banesën që prindërit e tij e kishin kthyer në hotel për personat që frekuentojnë llixhat e këtij qyteti. Ndërkaq, një shok i Qemal Selës tha dje në lidhje telefonike për "News 24", se ky i fundit ka pësuar dhunë psikologjike pas izolimit në një kamp të Londrës. Do të jetë ekspertiza që do të hedhë dritë nëse emigranti është i sëmurë mendor apo jo. Ndërkohë, edhe motra 14-vjeçare e të dyshuarit për vrasje ka përfunduar në gjendje shoku në spitalin e Peshkopisë, ku ndodhet nën kujdesin e mjekëve. Minorenia, (nxënëse e klasës së 8 të) është tronditur kur ka gjetur nënën dhe babain të pajetë e të mbuluar nga gjaku në katin e parë të hotelit, ku dhe banonin.

**DËSHMITË E VRASËSIT**

Qemal Sela, i cili pak pas krimit deklaroi se ka vrarë dy grabitës dhe jo prindërit e tij, ka dhënë dëshmi të reja në polici. Gjatë marrjes në pyetje (i kanë kërkuar të firmoste deklaratat e bëra për ngjarjen, 26-vjeçari është shprehur se nuk e ka emrin Qemal, pasi e kishte ndërruar në Angli. "Unë nuk jam Qemali, e kam emrin Zeqir", ka thënë i riu. I pyetur nga policia se ku e kishte gjetur kallashnikovin, me të cilin qëlloi prindërit e tij për vdekje, ai ka pohuar se armën e kishte fshehur në katin e parë të banesës para se të ikte në Angli. Mësohet se pas krimit të dyfishtë, Qemal Sela ka dalë në rrugë me automatik, të cilin e mbante në krahun e djathtë dhe me tytë poshtë. Pasi u përball me policinë, ai nuk bëri rezistencë. Ndërsa u ka thënë policëve: "Keni kujdes me armën se ka një fishek në gojë".



26-vjeçari Qemal Sela

**ARMA E KRIMIT**

Gjatë marrjes në pyetje (i kanë kërkuar të firmoste deklaratat e bëra për ngjarjen, 26-vjeçari është shprehur se nuk e ka emrin Qemal, pasi e kishte ndërruar në Angli. "Unë nuk jam Qemali, e kam emrin Zeqir", ka thënë i riu. I pyetur nga policia se ku e kishte gjetur kallashnikovin, me të cilin qëlloi prindërit e tij për vdekje, ai ka pohuar se armën e kishte fshehur në katin e parë të banesës para se të ikte në Angli.

## Shoku i të riut që vrau prindërit: Qemali pësoi dhunë psikologjike pas izolimit në kampin e Londrës

Ermir Rryçi nga Kruja, aktualisht azilkërkues në Angli tha dje në një lidhje telefonike për "News 24" se e njihte Qemalin që kur ishte transferuar në kampin e Hammer Sword në Londër tre muaj më parë. Sipas tij, kur e kishte takuar Qemalin në fillim ishte person normal, por pas izolimit që i bënë, ai ndryshoi. "E takova tri ditë më parë - tregon Ermiri - dhe më tha se donte të shkonte në Shqipëri të takonte prindërit dhe më pas do të rikthehej. Nuk e pashë shumë normal, dukej i shqetësuar. Diçka i kishte ndodhur, ndoshta nuk e ka përballuar dot mendërisht izolimin. Në kamp na trajtojnë jo si azilantë, por si të burgosur, birucat janë të vogla dhe pa kushte, është vetëm një krevat. Nuk na jep askush të drejtë për asnjë kërkesë tonën. Qemalin e futën në izolim pasi kishte pasur përplasje me një nga oficerët e kampit. Na izolojnë edhe pa shkak". "Unë - thotë - kam kërkuar vetë të hyjë në kamp, nuk kam shkelur asnjë rregull, përveç mungesës së dokumentacionit. Edhe mua më kanë izoluar disa herë për motive të kota, por fatmirësisht kam arritur ta përballoj mendërisht. I bëj apel ministrit të Jashtëm - thotë Ermiri - të interesohet për ne, të vijnë këtu në kamp dhe t'i shohë vetë kushtet, edhe mediave (shqiptare e angleze) të na filmojnë, nuk kërkojmë asgjë më shumë përveç të drejtave tona", tregon Ermir Rryçi nga kampi i azilantëve në Londër.



Hoteli në lagjen "Llixha" ku ndodhi vrasja

Gjykata lë në burg vrasësin e dyshuar dhe një bashkëpunëtor

## Vrasja në Vlorë, policia: Biznesmeni Vasil Dervishaj udhëtonte në makinë me një person tjetër

**VLORË** - Policia e Vlorës ka zbardhur të gjithë dinamikën e vrasjes së biznesmenit të kafesë në Vlorë, Vasil Dervishaj, i cili mësohet se udhëtonte në një makinë me një tjetër person, identiteti i të cilit nuk është zbuluar ende nga policia. Pas hetimeve të kryera, blutë kanë arritur në konkluzionin se autorët lëviznin të tre në një makinë. Mbrëmjen e 4 qershor kur ndodhi ngjarja, Amarildo Caushaj (i vetëdorëzuar), Erges Avdiu (në kërkim) dhe një person i tretë (i vetëdorëzuar) lëviznin me një automjet tip "Audi" me targa AA 830 RA, që u sekuestrua nga policia. Sipas të njëjtave burime, ata po shkonin në lagjen "Pavarësia" për në lokalin e 28-vjeçarit Amarildo Çaushi, aty ku mblidheshin çdo natë për të luajtur tavëll. Sapo janë futur në lagje, automjetit të tyre i ka prerë rrugën 29-vjeçari Dervishaj, i shoqëruar nga një person tjetër, edhe këta në makinë. Viktima ka tentuar të hapë krahun. Ai ka dalë nga makina dhe ka tentuar të mbushë armën tip kallashnikov. Në këtë kohë, Erges Avdiu pohohet të këtë nxjerrë pistoletën dhe e ka shkrepur në drejtim të Vasil Dervishit, pasi mendoi se ai do t'i qëllonte. Gjithashtu, policia sqaron se, Dervishaj mori një plumb në dorë dhe një në qafë në afërsi të kokës. Fjalët e fundit që i ka thënë personit që e shoqëronte kanë qenë: "Fute kallashnikovin në makinë". Pas këtij momenti, personi në fjalë ka marrë armën dhe e ka spostuar disa metra, ndërsa u ka kërkuar banorëve të zonës të lajmërojnë një ambulancë. Më pas është larguar në këmbë. Dëshmitarët e kanë përshkruar atë si një djalë të ri dhe të gjatë rreth 1.90 cm. Gjithashtu, policia bën me dije se në këtë kohë Amarildo Çaushaj dhe personi i tretë kanë tentuar të dalin nga automjeti, por Erges Avdiu i dha gaz makinës dhe i zbriti dy të rinjtë në afërsi të Portit, duke u thënë se dy të rinjtë nuk kishin lidhje me ngjarjen. Ndërkohë, Erges Avdiu i ka telefonuar Amarildo Grembit duke i kërkuar ta çonte deri në autostradë. Ky i fundit nuk ishte në dijeni të ngjarjes", tha policia. Ndërkaq, dje Gjykata e Shkallës së Parë të Vlorës vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj autorit të dyshuar të vrasjes, Amarildo Çaushi. E njëjta masë sigurie u vendos edhe për njërin nga bashkëpunëtorët e konkretisht, Amarildo Grembin. Ndërsa, është caktuar masa "arrest shtëpie" me mbikëqyrje elektronike për bashkëpunëtorin tjetër në vrasje, Nekid Arapi, 21 vjeç, pasi sipas hetimeve, ky i fundit ka shoqëruar autorët një pjesë rruge me makinën e tij, ndërsa nuk ka qenë në vendin e ngjarjes në momentin e vrasjes së biznesmenit Vasil Dervishaj. Ndërkaq, ndodhet ende në kërkim autori tjetër i vrasjes, Erges Avdiu.

**VENDIMI**

Gjykata e Shkallës së Parë të Vlorës vendosi dje masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj autorit të dyshuar të vrasjes, Amarildo Çaushi. E njëjta masë sigurie u vendos edhe për njërin nga bashkëpunëtorët dhe konkretisht, Amarildo Grembin.



Biznesmeni Vasil Dervishaj

## Manastirliu: 14 milionë euro fondet për investimet këtë vit, 5 mamografi të reja

# Nis shkolla 5-javore për 40 drejtorët e spitaleve publike

## *Synimi, shmangia e keqpërdorimeve të buxhetit*


Ogerta Manastirliu dje gjatë prezantimit të shkollës

Voltiza Duro

Rreth 40 drejtues të spitaleve publike në vend filluan dje një kurs intensiv për menaxhimin spitalor, në mënyrë që të shmanget keqpërdorimi i buxhetit. Kjo shkollë për drejtorët e spitaleve po hapet për herë të parë në Shqipëri dhe do të kryejë trajnime mbi menaxhimin e financave dhe burimeve njerëzore. E pranishme në këtë prezantim ishte dhe ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e cila vlerësoi rëndësinë e menaxhimit të spitaleve si element kyç për shërbime cilësore për qytetarët. "14 milionë euro janë investimet që po realizohen këtë vit në sektorin e shëndetësisë, duke filluar nga investimet në 11 spitalet rajonale me instalimin e 5 mamografëve të rinj, rezonancës magnetike për herë të parë në Elbasan, Angiografit për herë të parë në Fier për zgjidhjen e urgjencave kardiake e një seri investimesh në spitalet e Tiranës, duke filluar me repartet e reja të kirurgjisë dhe spitali i ri i sëmundjeve të brendshme në QSUT etj. Por, menaxhimi padyshim është i rëndësishëm për të pasur shërbime sa më cilësore për qytetarët, ndaj vendosëm të hapim për herë të parë shkollën e drejtorëve të spitaleve", tha Manastirliu. Më tej kjo e fundit theksoi se procesi i decentralizimit të spitaleve do të shoqërohet me llogaridhënie dhe transparencë. "Cikli i parë i menaxhimit spitalor do të hedhë bazat për menaxhimin e mirë të burimeve financiare. Përpara se të kërkohet rritje fondesh, duhet mirëadministruar fondi që spitalet kanë në dispozicion. Ndaj shkolla që po hapim sot, do vijojë me cikle të tjera - derisa çdo qindarke e parave publike të shkojë te pacienti, në funksion të përmirësimit të shërbimit për qytetarët", - u shpreh ministrja. Në fjalën e hapjes së shkollës së drejtuesve të spitaleve, ministrja theksoi se këtë vit do të garantohen barnat bazë në çdo spital, nuk do të ketë stoqe të barnave dhe skadenca të tyre, me lidhjen e marrëveshjes kuadër që lejon administrimin më të mirë të barnave në spitale përgjatë gjithë vitit. Sipas Manastirliut, shumë shpejt do të kryhet rankimi i spitaleve sipas performancës për të vijuar me procesin e akreditimit të tyre, ku padyshim thellimi i dijeve menaxherale për drejtuesit do të ndihmojnë në performancën e më të mirë të spitaleve dhe akreditimin më të shpejtë të tyre. Shkolla e drejtorëve nisi dje dhe do të vijojë për 5 javë me radhë gjatë fundjavave, ku drejtuesit e spitaleve do të trajnohen për t'u bërë menaxherë më të aftë për miradministrimin e burimeve financiare dhe njerëzore, që në thelb kulmojnë te një shërbim më cilësor për qytetarët. Lektorë të njohur dhe profesionistë të fushës vendës dhe të huaj do të drejtojnë këto kurse intensive. Nis që nga konceptet bazë të menaxhimit 'shkolla e drejtorëve', për të vijuar me menaxhimin e burimeve njerëzore, që nga punësimi, por edhe motivimi i stafit.

### INVESTIMET

**14 milionë euro janë investime që po realizohen këtë vit në sektorin e shëndetësisë.**

- Investime në 11 spitalet rajonale.
- Instalimi i 5 mamografëve të rinj.
- Instalimi i rezonancës magnetike për herë të parë në Elbasan.
- Instalimi i Angiografit për herë të parë në Fier për zgjidhjen e urgjencave kardiake.
- Investime në spitalet e Tiranës, duke filluar me repartet e reja të kirurgjisë dhe spitali i ri i sëmundjeve të brendshme në QSUT.

### PARATË PËR PACIENTIN

"Përpara se të kërkohet rritje fondesh, duhet miradministruar fondi që spitalet kanë në dispozicion. Ndaj shkolla që po hapim do vijojë me cikle të tjera, derisa çdo qindarkë e parave publike të shkojë te pacienti", - u shpreh ministrja.


Save the Children

**TENDER NOTICE**

Save the Children believes every child deserves a future. In Albania and around the world, we give children a healthy start in life, the opportunity to learn and protection from harm. We do whatever it takes for children – every day and in times of crisis – transforming their lives and the future we share.

Save the Children International in *Albania* is inviting submissions of tenders for a contract to provide the following products:

· *To construct two Crèches for children 0-3 age in city of Korce and Elbasan.*

Detailed technical specifications are included within the tender documents.

If you are interested in submitting a bid, please contact *Ina Sefa* at the following address procurement.albania@savethechildren.org or info.albania@savethechildren.org to express your interest and request the tender documents. Tender documents will be sent to you by return.

You may find full invitation to tender reference number 2018/001 at https://albania.savethechildren.net/work-for-us/service-provision.

It is recommended to request / collect the tender documents as soon as possible.

Completed tender documents are due to be submitted by *02/07/2018.*

ALBtelecom ...me ju të parët!

**Njoftim i shoqërisë ALBtelecom Sh.A.**

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së levizsshme se duke filluar nga data 16 korrik 2018, për pajtimtarët me parapagesë, do të ofrojë paketat 30 ditore Super me përfitimet si më poshtë:

| Paketat Super | Super 500 | Super 700 | Super 1100 | Super 1300 | Gigastike | Super 1900 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Çmimi (me TVSH) | 500 Lekë | 700 Lekë | 1,100 Lekë | 1,300 Lekë | 1,300 Lekë | 1,900 Lekë |
| Minuta Kombëtare (përfshirë rrjetet e tjera fikse) | 300 | 200 | 2500 | 3000 | 400 | 3500 |
| Minuta drejt rrjetit ALBtelecom Fiks | 300 | 400 | 500 | 3000 | 400 | 3500 |
| Minuta Ndërkombëtare | | | | 30 | | 60 |
| SMS drejt ALBtelecom Mobile | 300 | 400 | 1000 | 2500 | 400 | 3000 |
| SMS Kombëtare | | | 500 | 400 | | 300 |
| SMS Ndërkombëtare | | | | | | |
| Internet 3G/4G | | 300 MB | 3 GB | 5 GB | 5 GB | 12 GB |
| Internet 3G/4G+ | | | | | | 3 GB |
| Përfitime të tjera | | | | | 10 GB (Social & Chat) | |
| TV | | | | ALBtv Mobile | ALBtv Mobile | ALBtv Mobile |
| Vlefshmëria | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë |

Paketa 30 ditore Super 1000 nuk do të ofrohet më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët e kanë këtë paketë aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së saj.
Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën Super 500, Super 700, Super 1300 dhe Super 1900 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t'i përdorin këto paketa të pandryshuara deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

*Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123.*

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

# Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

## Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuesit janë në qarkun e Korçë. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitet e kërkuesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

**FORMULARI**

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjeneralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuara pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

**APLIKIMI**

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sektorit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatëse përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, si pas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI**

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera


FORMULAR APLIKIMI

INFORMIM NË LIDHJE ME ECURINË E DOSJES

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

KLAUZOLA DEKLARATIVE

## KORÇË

| Nr./Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti kerkues) | Atesia 2 | Mbiemri (Subjekti kerkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | Pogradec | Myrteza | Idriz | Hoxha | 4500 | Me Vendim Gjykate Ka Planvendosje Ka një Kërkesë Padi Kundër Vendimit të KKKP-së por S'ka në dosje Vendimi |
| 22 | Pogradec | Qemal | Enver | Kadilli | Nj=400 m2 Mos/Njohje=3372 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje |
| 21 | Pogradec | Lutfi | Irfan | Kadilli | 1449 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje |
| 19 | Pogradec | Qemal | Ramadan | Berberi | Nj=1428 m2 Mos/Njohje=4910 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje Trajtuar Sipërfaqa Trualli |
| 23 | Pogradec | Skender | Sherif | Çekiçi | 1211 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje |
| 7 | Pogradec | Shpëtm | Qamil | Qose | 198 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje Vendim Gjykate |
| 35 | Pogradec | Zhan | Xhevat | Starova | | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje |
| 20 | Pogradec | Suzana | Fejzo | Ylli | Nj=5248 m2 Mos/Njohje=1819 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje |
| 18 | Pogradec | Asllan | Nafail | Cake | Nj=3517 m2 Mos/Njohje=2198 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje Në Sipërfaqen e pretenduar nga subjekti 600 m2 I ka në zotërim të tij |
| 19 | Pogradec | Farie | Avdurraman | Balliu | 792 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje |
| 20 | Pogradec | Hasan | Rexhep | Balli | Nj=1392 m2 Mos/Njohje=2747 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje |
| 21 | Pogradec | Xhamia Zagorçan | | | Njohje Së Xhamisë me sip 1736 m2 Mos/Njohje=19850 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje |
| 1 | Pogradec | Neim | Mastan | Xhemallazi | Nj=1134 m2 Mos/Njohje=4262 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje |
| 8 | Pogradec | Banush | Gjon | Seitllari | 3713 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje |
| 9 | Pogradec | Nazar | | Shahin | 10250 | |
| | Pogradec | Nazar | | Shahin | | |
| 2 | Pogradec | Zini | | Kojtari | 5953 | Vërtetim Kadastral S'ka Planvendosje |
| 1 | Pogradec | Bashkim | | Minga | 3948 | Vërtetim Kadastral S'ka Planvendosje |
| 19 | Pogradec | Idirz | | Oshafi | 1158 | Nuk Ka Dokument Ligjorë Pronësie në Dosje Vendimi nuk ka Planvnedosje |
| 3 | Pogradec | Tefik | | Duka | 706 | Vërtetim Kadastral S'ka Planvendosje |
| 11 | Pogradec | Feleknas | | Pupa (Guri) | 1548 | Vërtetim Kadastral S'ka Planvendosje |
| 12 | Pogradec | Hysen | | Minga | 642 | Vërtetim Kadastral S'ka Planvendosje |
| 13 | Pogradec | Shefqet | | Duka | 3319 | Vërtetim Kadastral S'ka Planvendosje Ka Planvendosje Pretenduese |
| 6 | Pogradec | Ramadan | | Alushllari | Nj=290 m2 Mos/Njohje=210 m2 | Vërtetim Kadastral S'ka Planvendosje Ka Planvendosje Pretenduese Sipërfaqa 210 m2 jashtë vijave kufizuese |
| 4 | Pogradec | Tomorr | | Oshafi | 6790 | Vërtetim Kadastral S'ka Planvendosje Ka Planvendosje Pretenduese |
| 5 | Pogradec | Njazi | | Mimini | 3000 | Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje |
| 10 | Pogradec | Nexhat | | Mekolli | 5025 | Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje |

| Nr./Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti kerkues) | Atesia 2 | Mbiemri (Subjekti kerkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pogradec | Sefedin | | Mankellari | 4525 | Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje Pretenduese |
| 5 | Pogradec | Vasfi | | Caco | Nj=1567 5 m2 Mos/Njohje=3564 m2 | Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje Pretenduese Sipërfaqa 3564 m2 Jashtë Vijave Kufizuese |
| 4 | Pogradec | Esheref | | Caco | Nj=5164 m2 Mos/Njohje=440 m2 | Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje Pretenduese Sipërfaqa 440 m2 Jashtë Vijave Kufizuese |
| 3 | Pogradec | Asllan | | Caco | Nj=4924 m2 Mos/Njohje=2044 m2 | Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje Pretenduese Sipërfaqa 2044 m2 Jashtë Vijave Kufizuese |
| 1 | Pogradec | Selim | | Alushllari | 760 | Vërtetim Kadastral Nuk Ka Planvendosje |
| 24 | Pogradec | Mirat | | Oshafi | | Vërtetim Kadastral Sipërfaqa e Pronës së Pretenduar është Njohur Familjes Mimini me 24 dt. 02.11.1993 |
| 9 | Pogradec | Besim | | Minga | 320 | Vërtetim Kadastral Nuk Ka Planvendosje |
| 10 | Pogradec | Shebi | | Pupa | Nj=424 m2 Mos/Njohje=1871 m2 | Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje Sipërfaqa 1871 m2 Jashtë Vijave Kufizuese |
| 9 | Pogradec | Fazlli | | Agolli | 7200 | Vërtetim të Faktit Juridik Ka Planvendosje Të Seksionit të Urbanistikës Këshilli I Rrethit Pogradec |
| 6 | Pogradec | Sejat | | Isallori | Nj=250 m2 Mos/Njohje=810 m2 | Vërtetim Kadastral Nuk Ka Planvendosje |
| 5 | Pogradec | Esat | | Pengu | Nj=644 m2 Mos/Njohje=1631 m2 | Vërtetim Kadastral Nuk Ka Planvendosje |
| 4 | Pogradec | Enver | | Banollari | 672 | Vërtetim Kadastral Nuk Ka Planvendosje |
| 3 | Pogradec | Maliq | | Çela (Neziri) | Nj=2306 m2 Mos/Njohje=300 m2 | Vërtetim Kadastral Vendimi Ka Planvendosje Përkatëse |
| 7 | Pogradec | Xhevat | | Agolli | 6390 | Vërtetim Kadastral sip. 5000 m2 ndërsa sip. 1390 m2 me Vërtetim të Faktit Juridik Vendimi Ka Planvendosje Përkatëse |
| 2 | Pogradec | Bexhet | | Bardhi | Nj=2950 m2 Mos/Njohje=946 m2 | Vërtetim Kadastral Nuk Ka Planvendosje |
| 3 | Pogradec | Nevruz | | Mimini | 4500 | Vërtetim Kadastral Nuk Ka Planvendosje |
| | Pogradec | Nevruz | | Mimini | Nj=2000 m2 Mos/Njohje=7000 m2 | Vërtetim Kadastral Nuk Ka Planvendosje |
| 8 | Pogradec | Ismete | | Mimini | 2425 | Vërtetim Kadastral Nuk Ka Planvendosje |
| 2 | Pogradec | Xhevat | | Mimini | 11920 | Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje Pa Firmë dhe Vulë |
| | Pogradec | Xhevat | | Mimini | | |
| 20 | Pogradec | Nevres | | Hymetllari (Oshafi) | 1400 | Vërtetim Kadastral S'ka Planvendosje Ka Planvendosje Pretenduese |
| 21 | Pogradec | Lavdërim | | Mimini | 1350 | Vërtetim Kadastral S'ka Planvendosje Ka Planvendosje Pretenduese |
| 22 | Pogradec | Razmi | | Karafili | Nj=4182 m2 Mos/Njohje=2318 m2 | Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 23 | Pogradec | Belul | | Xhemollari | Nj=527 m2 Tr Mos/Njohje=5480 m2 T.B | Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje të Vendimit Vendimi pa Firmë dhe pa Vulë |
| 4 | Pogradec | Seit | | Minga | 1041 | Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje të Vendimit |
| 5 | Pogradec | Minire | | Basha (Kaftirani) | 2408 | Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje të Vendimit |
| 6 | Pogradec | Myfit | | Killo | 1511 | Vërtetim Kadastral Me Planvendosje të Vendimit |
| 7 | Pogradec | Diturije | | Duçi (Minga) | 1874 | Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje të Vendimit |
| 8 | Pogradec | Kibe | | Baçi | 1714 | Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje të Vendimit |
| 14 | Pogradec | Ramadan | | Lipo | 233 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 15 | Pogradec | Gjergji | | Qyshka | Nj=2660 m2 Mos/Njohje= 60 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 4 | Pogradec | Lytfi | | Ibi | 7660 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| | Pogradec | Lytfi | | Ibi | 1524 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 20 | Pogradec | Petro | | Gjoka | 264 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 12 | Pogradec | Vangjel | | Shegani | Nj=1828 m2 Mos/Njohje=307 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 6 | Pogradec | Avduladin | | Sulollari | 196 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 7 | Pogradec | Sotir | | Kratellari | 314 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 8 | Pogradec | Agim | | Shegani | 520 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 7 | Pogradec | Lytfi | | Rrapçe | 7798 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| | Pogradec | Lytfi | | Rrapçe | | |
| 15 | Pogradec | Meim | | Çela | Nj=10500 m2 Mos/Njohje=4500 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 11 | Pogradec | Selami | | Rrapçe | Nj=5548 m2 Mos/Njohje=9464 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Vërtetim I Faktit Juridik |
| 5 | Pogradec | Mitro | | Bice | 85 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Vërtetim I Faktit Juridik |
| | Pogradec | Agron | | Shegani | 1765 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Vërtetim I Faktit Juridik |
| 1 | Pogradec | Idajet | | Avdullari | 5000 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Vërtetim I Faktit Juridik |
| 4 | Pogradec | Faik | | Sulollari | 219 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Vërtetim I Faktit Juridik |
| | Pogradec | Spase | | Shegani | Nj=584 m2 Mos/Njohje=880 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Vërtetim I Faktit Juridik |
| 5 | Pogradec | Petraq | | Divjaka | 4800 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 1 | Pogradec | Demir | | Pura | Nj=4799 m2 Mos/Njohje=27701 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 2 | Pogradec | Dervish | | Mofulla | Nj=5262 m2 Mos/Njohje=7988 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 4 | Pogradec | Feim | | Hyka | | |
| 3 | Pogradec | Fuat | | Çela | | |
| | Pogradec | Fuat | | Çela | Nj=11336 m2 Mos/Njoh=26640 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 2 | Pogradec | Engjëllush | | Çela | Nj=1805 m2 Mos/Njohje=2195 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| | Pogradec | Engjëllush | | Çela | | |
| | Pogradec | Sabrie | | Çela | Nj=882 m2 Mos/Njohje=9080 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 22 | Pogradec | Myseret | | Elmazi (Ademi) | Nj=1400 m2 Mos/Njohje=6600 m2 | Vërteim I Faktit Juridik Ka Hartë |
| 6 | Pogradec | Azis | | Qorri | | |
| 1 | Pogradec | Rexhep | | Hyka | Nj=5010 m2 Mos/Njohje=2882 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 23 | Pogradec | Adile | | Ibi | 10900 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 4 | Pogradec | Feti | | Kume | | |
| 1 | Pogradec | Fatmir | | Duniceri | | |
| 2 | Pogradec | Hariz Duniceri | | Duniceri | Nj=911 m2 Mos/Njohje=2229 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 1 | Pogradec | Xhafer | | Mokrari | 8297 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| | Pogradec | Shyqyri | | Çela | Nj=13032 m2 Mos/Njohje=18680 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 9 | Pogradec | Vamçi | | Bice | 815 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 10 | Pogradec | Vitomir | | Bice | 157 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 11 | Pogradec | Guri | | Bice | 190 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 3 | Pogradec | Mihallar | | Bice | 714 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 9 | Pogradec | Maksut | | Muçi | Nj=3099 m2 Mos/Njohje=2022 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 21 | Pogradec | Marko | | Bice | Nj=917 m2 Mos/Njohje=141 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 24 | Pogradec | Ritvan | Avdyl | Kapo | 1076 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 25 | Pogradec | Bilal | Xhelil | Kapo | 1460 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 26 | Pogradec | | | | Mos/Njohje 1961 m2 | Sipërfaqja është Kompensuar me Truall ekuivalent Shteti |
| 3 | Pogradec | Ismail | Zenel | Aliçkolli | Nj=9332 m2 Mos/Njohje=24472 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| | Pogradec | Myfet | Rakip | Muçi | Nj=3870 m2 Mos/Njohje=2404 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 32 | Pogradec | Lutfi | | Ibi | 765 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 34 | Pogradec | Hazis | Xhemal | Muçi | Mos/Njohje 2580 m2 | Nga Sipërfaqëja 2580 m2 sip. 1400 m2 truall krijon mbivendosje me 178 dt. 08.11.1995 njohur subjektit Zyby Koçi ( Gega) |
| 33 | Pogradec | Beqir | Bektash | Muçi | 2289 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 8 | Pogradec | Adem | Rakip | Shyti | 564 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 9 | Pogradec | Vait | Izet | Jacelli | Nj=3660 m2 Mos/Njohje=1380 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 10 | Pogradec | Hasan | Njazi | Aliçkolli | 3317 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 12 | Pogradec | Mojsi | Fail | Belli | 900 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 27 | Pogradec | Xhevit | Demir | Ibi | Mos/Njohje= 187 m2 | Sipërfaqja është trajtuar nga Vendimi 27 dt. 10.03.1994 dhe Vendimi 73 dt. 04.05.1994 të KKKP Riza Ibit dhe Çaush Ibit |
| 28 | Pogradec | Safet | Feim | Besholli | 216 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 29 | Pogradec | Rexhep | Shaban | Balliu | Nj=10274 m2 Mos/Njohje=2472 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 30 | Pogradec | Dylbere | Rushan | Muçllari | 1000 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 5 | Pogradec | Rexhep | Riza | Aliçkolli | 8443 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 6 | Pogradec | Hekuran | Qazim | Jaçolli | Nj=1885 m2 Mos/Njohje=700 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 7 | Pogradec | Durim | Shefki | Aliçkolli | Nj=1862 m2 Mos/Njohje=3839 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 11 | Pogradec | Ferdone | Adem | Gjona | Mos/Njohje=2840 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 13 | Pogradec | Rexhep | Selim | Meko | Nj=933 m2 Mos/Njohje=250 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 15 | Pogradec | Hysmet | Selim | Mekolli | 1180 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 13 | Pogradec | Lytfi | Qamil | Besholli | Nj=4403 m2 Mos/Njohje=989 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 14 | Pogradec | Hekuran | Halim | Hyka | Nj=440 m2 Mos/Njohje=16685 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 15 | Pogradec | Fazlli | | Basholli | Nj=460 m2 Mos/Njohje=1124 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| | Pogradec | Fazlli | | Basholli | NJ=3600 m2 Mos/Njohje=577 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 3 | Pogradec | Flazi | Hysen | Zgjupa | Nj=1060 m2 Mos/Njohje=5940 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 12 | Pogradec | Ramadan | Qazim | Lufo | 6574 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 14 | Pogradec | Hysen | | Biba | Nj=495 m2 Mos/Njohje=16119 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 2 | Pogradec | Tafil | Sali | Biba | Nj=2581 m2 Mos/Njohje=8220 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Pa datë Vendimi I KKKP |
| 5 | Pogradec | Goni | Ali | Goxha | 3272 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 4 | Pogradec | Xhemile | Shefki | Nofulla | Nj=849 m2 Mos/Njohje=2663 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 18 | Pogradec | Telha | Bilal | Çela | Mos/Njohje 7000 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Sipërfaqja është trjatuar me 57 dt. 11.04.1994 KKKP subjekt Fuat e Agim Çela |
| | Pogradec | Pëllumb | | Çela | 10095 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| 10 | Pogradec | Rexhep | Adem | Lato | NJ=7500 m2 Mos/Njohje17189 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë |
| | Pogradec | Ramadan | Dalip | Torra | 1480 | |
| 9 | Pogradec | Myslym | Hasan | Lufo | Nj=8425 m2 Mos/Njohje=17442 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Është trajtuar sipërfaqa e truallit |
| 8 | Pogradec | Zydi | Isuf | Çela | Nj=9148 m2 Mos/Njohje=55119 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Është trajtuar sipërfaqa e truallit |
| 5 | Pogradec | Leka | Haxhi | Çela | Mos/Njohje=2418 m2 | Vërtetimi I Arkivit të Shtetit Ka Hartë Sipërfaqja Jashtë Vijave Kufizuese të Fshatit |
| 12 | Pogradec | Guri | | Molla | 450 | Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 3 | Pogradec | Jonuz | | Liçkollari | Nj=252 m2 Mos/Njohje=188 m2 | Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosje Vendimi |
| | Pogradec | Jonuz | | Liçkollari | | Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 6 | Pogradec | Shefqet | | Purba | 4237 | Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 13 | Pogradec | Bajame etj. | | Zeqollari | 3496 | Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 1 | Pogradec | Shkelqim | | Zgjani | 1110 | Me Vërtetim Kadastral Vendimi me Planvendosje |
| | Pogradec | Shkelqim | | Zgjani | 308 | Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 15 | Pogradec | Nedime | | Zgjani | Nj=2907 m2 Mos/Njohje=6395 m2 T.B | Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 8 | Pogradec | Ardian | | Muçollari | 2833 | Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 1 | Pogradec | Hamit | | Jaçelli | 4810 | Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje |
| 2 | Pogradec | Myrteza | | Hyka | 4631 | Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje |
| 12 | Pogradec | Kujtim | | Besholli | 10090 | Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje |
| 21 | Pogradec | Zylfi | | Ibi | Nj=532 m2 Mos/Njohje=387 m2 | Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje |
| 6 | Pogradec | Xhevit | | Haxhollari | 3740 | Me Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 20 | Pogradec | Kurti | | Koçillari | 928 | Me Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 17 | Pogradec | Sabri | | Lipo | Nj=290 m2 Mos/Njohje=1899 m2 | Me Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 4 | Pogradec | Lumturie | | Latifllari | 2188 | Me Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje Vendimi |
| 9 | Pogradec | Zalo dhe Agim | | Kuqo | | |
| 17 | Pogradec | Servet | | Lamçe | 331 | Me Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 22 | Pogradec | Fejzi | | Hoxhallari | 902 | Me Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 6 | Pogradec | Fazlli | | Pengu | Nj=1785 m2 Mos/Njohje=1931 m2 | Me Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Vendimi |
| 14 | Pogradec | Mereme | | Sulollari | Mos miratoje kerkesen | |
| 25 | Pogradec | Nefail | | Pengu | Nj=220 m2 Mos/Njohje 2002 m2 | Me Vërtetim Kadastral Vërtetim I Faktit Juridik Ka Hartë |
| 24 | Pogradec | Enver | | Hoxha | 1768 | Me Vërtetim Kadastral Ka Hartë |
| 38 | Pogradec | Koço | | Kresto | 850 | Vendimi ka Hartë Por nuk ka dokument Ligjorë |
| 16 | Pogradec | Njazi | | Cane | Nj=3802 m2 Mos/Njohje=400 m2 | Vërtetim I Arkivit Shtetëror Ka Hartë |
| 18 | Pogradec | Bujar | | Lipo | Nj=1375 m2 Mos/Njohje=3000 m2 | Vërtetim I Arkivit Shtetëror Ka Hartë |
| 8 | Pogradec | Shaban | | Daci | 3538 | Vërtetim I Arkivit Shtetëror Ka Hartë |
| 169 | Pogradec | Lavdie | | Naço | Mos miratoje kerkesen | |
| 39 | Pogradec | Fatmir | | Hoxhallari | 972 | Vërtetim I Arkivit Shtetëror Ka Hartë |
| 15 | Pogradec | Fluturak | | Belli | 1376 | Vërtetim I Arkivit Shtetëror Ka Hartë |
| 124 | Pogradec | Dhimitër | | Guçi | Nj=4160 m2 Mos/Njohje=1163 m2 | Vërtetim I Arkivit Shtetëror Ka Hartë |
| 26 | Pogradec | Pranvera | | Lamçe | Mos miratoje kerkesen | |
| 6 | Pogradec | Flamur | | Bardhi | 560 | Vërtetim I Arkivit Shtetëror Ka Hartë |
| 2 | Pogradec | Shpëtim | | Baçllari | Nj=546 m2 Mos/Njohje=204 m2 | |
| 9 | Pogradec | Hysni | | Aliçkolli | 8134 | Vërtetimi I Faktit Juridik Ka Hartë |
| 11 | Pogradec | Nazif | | Kadilli | Nj=1191 m2 Mos/Njohje=5713 m2 | Vërtetimi I Faktit Juridik Ka Hartë |
| 7 | Pogradec | Kujtim | | Zhudi | 170 | Vërtetimi I Faktit Juridik Ka Hartë |
| 5 | Pogradec | Agjerim | | Kadilli | 2503 | Vërtetimi I Faktit Juridik Ka Hartë |
| 14 | Pogradec | Riza | | Dikellari | 1287 | Kontratë Shitblerje Vërtetimi I Faktit Juridik Ka Hartë |
| 3 | Pogradec | Rami | | Pengu | | Nuk Ka Dokument Ligjorë |
| 18 | Pogradec | Selami Ibi | Bedulla | | Nj=565 m2 Mos/Njohje=165 m2 | Vërtetim I Arkivit Shtetëror Ka Planvendosje Për Sipërfaqe 165 m2 kjo është trajtuar me 43 dt. 13.12.1993 KKKP në emër të Mersin Ibi |
| 17 | Pogradec | Qazim Ismail | | Zyalali | Nj=4245 m2 Mos/Njohje=5231 m2 | Vërtetim I Arkivit Shtetëror Ka Hartë Trajtuar sip. E truallit |
| 16 | Pogradec | Ambeli | Rustem | Kapo | 900 | Vërtetim I Arkivit Shtetëror Ka Hartë |

*(vijon)*

BLUE TOOTH
Thashetheme
MADE IN ALBANIA
Nr. 613
SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE
Redaktore: Pamela ALIAJ - Art Designer: Nevila Samarxhi
E shtunë 9 Qershor 2018

"NXEHET" RIKJA, KUJT I NXJERR GISHTIN E MESIT?



# "DANCING WITH THE STARS 7"

## Finalja, kush pretendon ta rrëmbejë kupën?





*Aulona Musta e sigurtë në fitore: Vetëm po u bë qameti nuk e fitoj! Gjashtë finalistët e show-t të famshëm, prapaskenat dhe të eliminuarit*

LARGOHET NGA "IN TV". "JU RRËFEJ PRAPASKENAT E EMISIONIT TË RI"



# ALFIO RROTANI:

20-VJETORI I "MISS SHQIPËRIA"

# JONIDA SHEHU

## i rikthehet ekranit





20-vjetori i "Miss Shqipëria", ja cilat do të jenë surprizat e dy netëve

# Jonida Shehu i rikthehet ekranit

Pamela Aliaj

Vetëm pak ditë kanë mbetur nga finalja e "Miss Shqipëria 2018", ndërsa organizatorët e eventit të vetëm të bukurisë në vend kanë zbuluar për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" disa nga detajet e këtij spektakli. Në këtë edicion të konkursit të më të bukurës shqiptare do të konkurrojnë 32 vajza nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, por edhe vende të tjera ku jetojnë shqiptarë. Bukuroshet e këtij viti kanë përmbyllur turin e përhershëm të "Miss Shqipërisë", ku kanë parë qytete të ndryshme, kanë vizituar zona dhe treva të lashta historike dhe turistike, nga deti në mal dhe aktualisht kanë filluar përgatitjet për natën e madhe. Por, ky edicion do të jetë i veçantë dhe i ndryshëm nga ata paraardhësit. "Miss Shqipëria" sivjet feston 20-vjetorin dhe për këtë arsye edhe festa që do të organizohet në Kalanë e Tiranës do të jetë speciale dhe jo një, por dy net radhazi. Kështu, mbrëmjen e 10 qershorit do të parakalojnë në skenën e "Miss Shqipërisë", përveç konkurrenteve për më të bukurën, edhe shumë të ftuar specialë dhe miq të "Deliart Association". 20 vite nënkuptojnë shumë bashkëpunime dhe kujtime, aventura dhe sfida të cilat do të risillen në vëmendje nga vetë protagonistët. Ndërsa nata e dytë, ajo e 11 qershorit do të jetë finalja festive, në fund të së cilës juria do të përzgjedhë mbretëreshën e këtij viti. Surpriza e tretë që organizatorët kanë zbuluar sot janë emrat e prezantuesve. Për ata që u ka munguar, Jonida Shehun do të kenë mundësi ta ndjekin sërish nga ekrani me gjithë sharmin dhe karizmën në prezantim. Ajo do të ngjitet në skenë bashkë me dy vëllezërit e njohur, Donald dhe Romeo Veshaj. Një trio që ka filluar ndërkohë provat për të sjellë një prezantim krejt ndryshe nga ajo çfarë jemi mësuar deri më sot. Surpriza të tjera? Ka plot të ftuar specialë ky vit. Por shumë prej detajeve do të tregohen të dielën dhe të hënën në eventin special të "Miss Shqipëria 2018".













# Nuk ka ndryshuar fare! Angela Martini bëhet nostalgjike për fëmijërinë









Të gjithë shpesh bëhemi nostalgjikë për të shkuarën tonë. Kjo na bën t'u kthehemi pas kujtimeve falë fotografive, të cilat kanë arritur të 'ngrinë' një pjesë të tyre. Mesa duket, edhe modelja e njohur Angela Martini është ndjerë pak nostalgjike. Së fundmi ajo vendosi të postojë në "Instastory" disa foto të vegjëlisë së saj. Nga fotot duket se nuk ka ndryshuar aspak në pamje, duke i dhënë premisat e një modeleje që në adoleshencë. E bukur dhe një superseksi si atëherë, edhe tani mbetet modelja shqiptare.



## Temperaturat në majë, Enca provokon duke kapur gjoksin



Këngëtarja e njohur shqiptare, Enca Haxhia, njihet për provokimet që bën me daljet e saj të shumta në rrjetet sociale, duke u shfaqur shumë seksi dhe duke nxitur kështu komentet e ndjekësve të saj. Pas publikimit të hitit të fundit, "Dua" nga i cili dolën shumë polemika lidhur me videoklipin, këngëtarja ka nisur pushimet duke shijuar rrezet e diellit në pishinë. Por edhe pse pushim, ajo nuk harron të postojë në rrjetet sociale foto provokuese. Në të fundit këngëtarja ka dalë me një palë rrobabanjo duke kapur gjoksin. Me siguri që kjo do të jetë thjesht fillimi i një maratone të gjatë me foto provokuese për këtë verë, që ende s'ka filluar. Bëhuni gati!





## "Nxehet" Rikja, kujt i nxjerr gishtin e mesit?

Tashmë e dimë se shumë nga personazhet e mediave rozë, që shpesh janë në 'lupë', bezdisen apo edhe nevrikosen lidhur me lajmet që dalin rreth tyre, apo edhe ndaj komenteve që ndjekësit e shumtë u bëjnë. Dhe një sjellje të tillë nuk e lënë të kalojë lehtë duke reaguar nëpër rrjete sociale nëpërmjet postimeve të ndryshme që bëjnë. Një gjë të tillë duket se e ka bërë edhe ish-banorja e "Big Brother", Rike Roçi e cila prej kohësh tashmë jeton në Itali. Në një postim të sajin të fundit, ajo kishte nxjerrë një foto ku tregonte gishtin e mesit me nënshkrimin: "Ndonjëherë më vjen t'u përgjigjem kështu"! Me kë të jetë nxehur vallë Rikja?

**Flet autori i "Kripë dhe Piper": Përveç gatimit, ja cilat janë pasionet e mia "të rrezikshme"**

# Largohet nga "In TV", flet ALFIO RROTANI: Ju rrëfej prapaskenat e emisionit të ri

## "Shqipëria më ka dhënë shumë suksese, përveç kuzhinës"



*Nëpër mediat rozë nuk ka se si t'i shpëtojnë 'lupës' edhe ata që janë vetë pjesë e medias. Këtë herë në 'lupën' tonë ka qenë një ndër kuzhinierët më karizmatikë dhe më të dashur të ekranit. Të gjithë e mbajmë mend djalin që vinte nga një eksperiencë pune në Itali dhe na mahniti në "MasterChef" me gatimet e tij. Po flasim pikërisht për Alfio Rrotani, i cili është jo vetëm fituesi i edicionit të parë të "MasterChef Albania", por gjithashtu edhe një nga dy autorët që drejton "Kripë e Piper" në "In TV". Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", ai ka rrëfyer disa nga prapaskenat e emisionit të ri, që do të hapë së shpejti në TV "Klan". Gjithashtu, ai ka folur edhe për pasionet e tij të fshehta, përveç gatimit. Ai paraqitet ndryshe, në një intervistë plot humor, ashtu si edhe vetë Alfio Rrotani.*



Pamela Aliaj

**Jeni një ndër shefat më të parapëlqyer të vendit. Përse zgjodhët të qëndroni në Shqipëri me gjithë talentin që keni e jo të tentoni jashtë vendit?**

Unë artin e gatimit e kam nisur jashtë vendit, ku kam pasur sukses dhe ia kam dalë shumë mirë. Në fund të ditës isha gjithmonë me valixhe në dorë. Shqipëria më ka dhënë suksese të tjera përveç kuzhinës: një dashuri, një familje dhe një jetesë siç unë e kisha projektuar në mendjen time.

**Si ju erdhi ideja e "Kripë e Piper"?**

Erdhi krejt natyrshëm. Duke parë formatet e kuzhinës, që ishin pothuaj









njëlloj dhe shumë teknike. Vendosëm të bënim diçka ndryshe, pa filtra e më të thjeshtë, të kuptueshëm dhe pse jo, me pak humor.

**Thuhet se do të lëvizni nga "IN TV" me emisionin tuaj për të kaluar diku tjetër. Pse ky ndryshim? A kishit ndonjë pakënaqësi me produksionin apo... ?**

Është e vërtetë që do lëvizim. Këto dy vite kanë qenë tepër të bukura në "In TV". Mendoj që "In TV" është një trampolinë për këdo. Pas një eksperience me energji shumë të mirë, mendojmë se ka ardhur momenti për gjëra ndryshe dhe më të mëdha.



**Ku do t'ju shohim së shpejti?**

Së shpejti do na shihni në TV "Klan".

**A do të jetë i njëjti format me të ftuar VIP-a, apo do të ndryshojë diçka?**

Projekti i ri është diçka komplet ndryshe, një risi në ekranet shqiptare. Do jetë për shqiptarët kudo në qytetet e Shqipërisë. Do ketë surpriza, receta, e sigurisht edhe shumë të papritura.

**A keni menduar të hapni një restorant tuajin?**

Përveç televizionit dhe mësimdhënies tek instituti kulinar "Neranxi", merremi gjithashtu me organizimin dhe hapjen e restoranteve të reja, siç edhe ne e quajmë "start up". Do na pëlqente shumë. Por fakti që po hapim kaq shumë restorante nuk na lë kohë për një restorant tonin. Do ishte më mirë sikur jo 24, por 48 orë të kishte dita, atëherë po, mund ta hapnim një restorant. (Qesh)

**Nëse nuk do të vijonit këtë pasion që keni për gatimin, me çfarë do të merreshit tjetër në jetë?**

Nëse nuk do isha kuzhinier, me siguri do isha mekanik i shkëlqyer, sepse që në vegjëli montoja e çmontoja çdo pajisje që më vinte në dorë. (Qesh)

**Cili është një tjetër pasion i fshehtë i Alfios?**





Në fakt kam shumë. Disa të rrezikshëm, disa jo. (Qesh) Përveç motorëve, pikturës dhe udhëtimeve nëpër botë, një pasion i fshehtë i imi është peshkimi.

**Cili ka qenë personi nga i cili keni trashëguar apo jua ka "ngjitur" këtë pasion për gatimin?**



Mami gatuante gjithmonë gjëra të mira dhe unë inspirohesha. Por kur nisi të punonte dy punë në Itali, unë dhe motra nisëm të gatuanim në shtëpi kur ishim tepër të vegjël. Aty nisi gjithçka.

**Çfarë lloj gatimi nuk i reziston dot Alfio?**

Unë jam gjithçkangrënës. Të preferuarat janë gatimet ku përfshihen frutat e detit. Vdes për krudo. (Qesh)

**Ju padyshim jeni një shef në kuzhinë dhe ekspert në shumë gatime. Por a është dikush për të cilin ju gatuani dhe ndani ushqimet më të shijshme, njeriu i zemrës për shembull?**

Fatmirësisht po! Kur ndodh rrallë që kam ndonjë ditë pushimi, gatuaj bashkë me të dashurën duke shijuar ndonjë gotë verë. Problemi është se bëhemi tapë para se të përfundojmë gatimin. (Qesh)

# Liami fillon të lexojë! Vesa Luma na kënaq sytë me këtë foto




Prej kohësh ajo është shkëputur për një jetë më të mirë me familjen në Zelandën e Re. Por herë pas here, këngëtarja kosovare, Vesa Luma poston foto për ndjekësit e saj në "Instagram". Shpesh ajo tregon jetesën e tyre në kontinentin tjetër, duke shfaqur herë pas here edhe vogëlushin Liam, i cili mesa duket po rritet shpejt. Në një foto të fundit e shohim ndërsa në duar mban një libër dhe është ulur në një bibliotekë për fëmijë. Sa shpejt kalon koha!



# "Më vjen të bëj asgjë!" Të gjithë do të donim të ishim në vend të Jonida Maliqit



Pushime, pushime dhe vetëm pushime! Ndërsa temperaturat rriten dhe të gjithë ne jemi duke pritur ditët e pushimit, VIP-at tanë tashmë i kanë nisur ato. Një ndër to është edhe këngëtarja e hitit "Në errësirë", Jonida Maliqi. Së bashku me familjen kanë vendosur t'i kalojnë pushimet në një nga resortet e Turqisë. Në një foto të postuar së fundmi në "Instagram" shihet se si është duke i shijuar në maksimum rrezet e diellit. "Më vjen të bëj asgjë!", shkruan Jonida. Eh, të ishim edhe ne në vend të saj, ashtu do ta mendonim!






# 'Shpërthen' sërish! Ja si vjen këtë radhë Luana Vjollca

Pas shkëputjes nga televizioni, ajo bëri një periudhë pauze, të cilën të gjithë e menduam si një 'ndarje' definitive nga media. Por, pavarësisht planeve që ka për në shtator, Luana Vjollca duket se nuk ka ndenjur kot! Dje ajo publikoi këngën e saj të fundit në të cilën nuk vjen vetëm dhe për më tepër, vjen krejtësisht ndryshe! Të gjithë jemi mësuar ta shohim provokuese në kulm dhe shumë sensuale në videot e saj, ndërsa në këtë të fundit, Luana në bashkëpunim me këngëtarin Bujar Qamili vjen në një version ndryshe. Mbase një këngë e tillë do të sjellë një tjetër sukses për të dy këtë verë.



# Gjithnjë të dy, Miriam Cani poston foton që përmban 100% dashuri

Nuk është se postojnë shpesh foto bashkë, duke dashur të mos jenë edhe tepër të ekspozuar në media, por mesa duket këtë radhe nuk i ka rezistuar dot Miriam Cani. Vetëm para pak disa ditësh festoi ditëlindjen vëllai i Alban Skënderaj, të cilit ajo i bëri një dedikim të veçantë. Por pas këtij postimi nuk kishte se si të mungonte fotoja me dashurinë e jetës së saj, Albanin. Një foto e thjeshtë, e postuar në "Instastory", por që flet shumë!











## Aulona Musta e sigurtë në fitore: Vetëm po u bë qameti nuk e fitoj!

# Finalja e "Dancing with the stars Albania", kush pretendonte ta rrëmbente kupën?

### *Gjashtë finalistët e show-t të famshëm, prapaskenat dhe të eliminuarit*

Pamela Aliaj

Prej tashmë dymbëdhjetë netësh, çdo të premte është shfaqur një ndër emisionet më të shikuar në Vizion Plus, "Dancing with the Stars Albania". Nata e parë nisi në mars ku u rikthyen më të mirët e gjashtë sezoneve më parë. Duke përmendur këtu: Soni Malaj, Rovena Dilo, Aulona Musta, Mariza Ikonomi, Diellza Kolgeci, Rike Roci, Amos Zaharia, Landi Forina, Viktor Zhusti, Kristi Popja dhe Niko Komani. Ndërkohë që në moderim ka qenë ish-misi i Shqipërisë, bukuroshja Almeda Abazi së bashku me moderatorin Rudi Hizmo, të cilët i kanë dhënë shumë ngjyra këtij show në sajë të prezantimit të çdo të premteje në mbrëmje. 12 çiftet që hapën siparin e këtij sezoni performuan në zhanre të ndryshme muzikore, ku vlerësimi erdhi nga e njëjta juri, Ema Andrea, Ilir Shaqiri dhe Alfred Kaçinari. Një tjetër e veçantë e këtij sezoni ishte dhe pjesëmarrja aktorit Julian Deda. Ai e nisi mbrëmjen e parë të "Dancing with the stars" si konkurrent, por që më vonë u bë anëtari i katërt







i jurisë. Spektakli, emocionet dhe ethet e garës me personazhe të njohur na shoqëruan për 11 javët në vazhdim. Ndërkaq shumë surpriza u prezantuan mbrëmjen e finales së sezonit të shtatë duke përfshirë këtu edhe rikthimin e të eliminuarve. Ndërkohë që me eliminimin e disave prej tyre, duke nisur me ish-banoren e Big Brother, Rike Roçi e të tjerëve pas saj, në finale mbrëmë mbetën vetëm gjashtë VIP-a. Por ajo që bëri më tepër përshtypje ndër të tjera ishte deklarata e njërës prej gjashtë finalistëve. Ajo është padyshim një ndër personazhet më të lakuara në këtë konkurs, e cila njihet për dashurinë e saj për kërcimin dhe pasionin që shfaq dukshëm në daljet e saj në çdo kërcim. Po flasim pikërisht për Aulona Mustën, një nga autoret e emisionit "Thumb", e cila e ftuar në "Boom" të "Ora News" tha se ishte më se e sigurtë se do të ishte ajo fituesja e "Dancing with the stars 7". "Dancing with the stars" do ta fitoj unë. Vetëm po u bë qameti të mos ta fitoj!", ka thënë moderatorja. Fituesi i edicionit të 7 të "Dancing with the stars" gjithnjë ka qenë vetëm 1, dhe u zgjodh vetëm nga publiku. Juria këtë radhe ishte si një spektator i privilegjuar duke pasur mundësi vetëm të shijonte kërcimet e veçanta, dhe jo të votonte. Ajo që i dha akoma më tepër ngjyra finales ishin padyshim të ftuarit specialë, si aktori i famshëm turk Tolgahan, që është njëkohësisht edhe bashkëshorti i moderatores Abazi, si dhe Mr. Bean e këngëtarë shqiptarë si të ftuar specialë. Fitore e merituar? Gjithmonë mbetet në duart e teleshikuesve!









Opinioni i Ditës

# Halli i përbashkët i berberit tim në Prishtinë dhe i pronarit të lavazhit në Kavajë

Nga Veton Surroi

*(vijon nga faqja 1)*



… është duke marrë pjesë që tani në tregun e punës të BE-së, e BE-ja do ta mashtrojë Shqipërinë dhe veten kinse nuk di se kjo po ndodh”

1.

Berberi im në Prishtinë ka nja gjashtë muaj që e ka të hapur konkursin për berber/asistent. Atyre që pranojnë ua jep përvojën e tij falas dhe një rrogë minimale prej 350 eurosh. Deri më sot nuk ka të lajmëruar për vend pune.

Dikur, dhe jo shumë moti, para luftës, ekzistonte tradita e kallfasë, të atij që shkon e merr mësim te ustai dhe pastaj, kur ta marrë zanatin, i hyn punës. Familjet i çonin fëmijët e tyre për të marrë zanat, pa pritur të merrnin rrogë. Herë-herë duhej qerasur mjeshtrin që ta pranojë fëmijën për atë që sot quhet asistent zanati.

Por kjo nuk ndodh sot. Berberi im, në analizën më të mirë sociologjike për momentin, cek dy faktorë thelbësorë pse të rinjtë nuk lajmërohen në konkurs fare. Njëri është faktori evolutiv (kohë) dhe tjetri, i lidhur me të, faktori i projeksionit alternativ të ardhmërisë. Në fakt, berberi tha diçka më të thjeshtë: “nuk e do kush paren me rrogë, dalëngadalë” dhe “çdonjëri po i pret vizat e me dalë”. Por, kur e përkthen në rrafshet kohore, del se në kulturën e të rinjve – të atyre që nuk lajmërohen në konkursin e berberit – nuk ekziston bindja se në formë evolutive – së pari, si asistent, pastaj si berber, pastaj si pronar dyqani vetjak – mund të arrihet rehatia ekonomike e sociale. Dhe dy, edhe po të ekzistojë një evolucion i këtillë, më mirë që ai të bëhet diku jashtë Kosovës – në Zvicër, Gjermani, Suedi.

Liberalizimi i vizave, kështu, nuk është vetëm faktor politik – njëra qeveri ra gjoja ngase nuk mund të siguronte liberalizimin e vizave e tjetra, që është sot në pushtet, këtë e mori gjoja sepse do ta sigurojë liberalizimin e vizave – por është faktor determinues ekonomik e social.

Dhe e dikton kohën.

Nuk janë duke e pritur lajmin për liberalizimin e vizave vetëm partitë e përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, për të arsyetuar veprimin e vet politik pro apo kundër, por është duke e pritur një lumë joaktiv i njerëzve, të cilët me t’u liberalizuar vizat do të ruajnë dy mijë apo tre mijë euro që i kanë marrë borxh apo kursyer familjarisht për të ikur rrugëve ilegale dhe do të nisen për në aventurën që duhet t’u krijojë jetë të re.

Paradoksalisht, qeveria më e suksesshme kosovare do të bëhej, pra, ajo që siguron që sa më shumë njerëz të largohen sa më shpejt nga Kosova për në Europë. Dhe ky është indikatori më i mirë sesa është besimi në perspektivën personale brenda vendit.

Pronari i lavazhit në Kavajë, ku e laj veturën, e ka hallin pothuajse të njëjtë. Nuk po mund të gjejë punëtorë për të larë vetura. Ata që i kishte ikën, kush në Holandë e kush në ndonjë shtet tjetër. Vazhdojnë të lajnë vetura, por këtë e bëjnë në Holandë a ndonjë shtet tjetër, dhe dy shpjegimet sociologjike të berberit tim janë të vlefshme edhe për ata. Evolucionin e tyre e shohin duke larë vetura, fillimisht, e pastaj ndoshta të jenë edhe pronarë – por pronarë në Holandë, ku kostoja e punës është shumëfish më e lartë sesa në Kavajë dhe ku, të vendosur në një tren stabil i quajtur shtet social i së drejtës që ka ecur me qindra vjet më herët e do të ecin qindra vjet më tutje, mund të parashihet ardhmëria e sigurt.

Janë axhustatorët, muratorët, kamerierët – më thotë një pronar hoteli dhe ndërtimtar – që po ikin me të madhe. Pra, ata që nuk kanë nevojë as të mendojnë në formë evolutive: si axhustator e murator mund të fillosh tash e të punosh deri në pension dhe do të kesh një jetë të respektueshme.

Dhe, janë edhe infermieret dhe mjekët që po shkojnë. Prej shtetit ku ende mund të zbulosh sëmundje që janë harruar në vise të tjera të Europës, shkojnë mjekët dhe infermieret shqiptarë për të hyrë në një garë të sistemeve të avancuara të mjekësisë në nivel botëror, siç është rasti me Gjermaninë a Suedinë.

> Pronari i lavazhit në Kavajë, ku e laj veturën, e ka hallin pothuajse të njëjtë. Nuk po mund të gjejë punëtorë për të larë vetura. Ata që i kishte ikën, kush në Holandë e kush në ndonjë shtet tjetër. Vazhdojnë të lajnë vetura, por këtë e bëjnë në Holandë a ndonjë shtet tjetër, dhe dy shpjegimet sociologjike të berberit tim janë të vlefshme edhe për ata.

Qeveria e Shqipërisë do ta shënojë si sukses të vetin fillimin e negociatave për anëtarësim në BE. Në fund të atij procesi shtetet anëtare të BE-së mund ta pranojnë Shqipërinë si shtet anëtar, duke i vënë kufizime kohore për të marrë pjesë në tregun unik të punës.

Nëse fillojnë negociatat në qershor, i tërë dhjetëvjetëshi i ardhshëm do të kalojë në mashtrim të ndërsjellë. Shqipëria do të përpiqet ta mashtrojë BE-në se nuk është duke marrë pjesë që tani në tregun e punës të BE-së, e BE-ja do ta mashtrojë Shqipërinë dhe veten kinse nuk di se kjo po ndodh.

BE-ja mund të shikohet si një aspirator i madh. Së pari i thith njerëzit, e nëse ia vlen edhe shtetet ku jetuan ata njerëz. Kështu ndodhi me portugezë e spanjollë, grekë e kroatë, bullgarë e rumunë. Restorantet dhe kantieret e ndërtimit janë histori evolutive integrimi: dikur ishin spanjollët kamerierë e pastaj erdhën bullgarët, dikur ishin portugezët muratorë e pastaj u bënë polakët dhe pastaj rumunët.

Dallimi mes të gjithë këtyre është se shqiptarët janë nja 50 vjet andej, prejse Mareshali Tito vendosi se është më mirë të kesh emigracion të pasur se popullatë të varfër e të pakënaqur. Dhe, për dallim prej të gjithë këtyre, shqiptarët, këta të Kosovës, nuk shohin ende pikën kritike ku aspiratori i madh i BE-së do të fillojë të thithë brenda pos njerëzve edhe shtetet.

Në rastin më të mirë, shqiptarët e Kosovës presin që të jenë si shqiptarët e Shqipërisë, të kenë të drejtë me pasaportën e tyre të dalin e të kërkojnë punë në Europë pa vizë. Në rastin më të mirë, shqiptarët e Shqipërisë presin të jenë si serbët, një shtet që negocion për t’u anëtarësuar në BE, por pa i rregulluar ende punët në shtëpi; njëri shtet nën influencë të madhe të krimit të organizuar të drogës, tjetri shtet nën influencën e madhe të krimeve kundër njerëzimit dhe derivateve më të rëndomta kriminale.

Ka mbetur një traditë, pak nga turizmi, pak nga librat e historisë, që shqiptarët të nisin delegacionet e veta nëpër kryeqytete të Europës për t’u ankuar për padrejtësitë që u bëhen shqiptarëve. Para njëqind vjetësh delegacionet e mustaqokëve – gegë e toskë, priftërinj e shkrimtarë – që shkonin për t’iu treguar kancelarive të Perëndimit se nuk jemi otomanë, se jemi sikur ta, se do bëhet padrejtësi po të mos na bëjnë shtet. Pas njëqind vjetësh, delegacionet nga Shqipëria e Kosova nisen për diçka që sot quhet lobing; delegacionet shqiptare, të të dyja shteteve kanë pothuajse të njëjtin refren: na bëhen padrejtësi, nuk jemi otomanë, jemi evropianë. Dhe, kërkesa: meqë jemi europianë, na e bëni shtetin (shtetet) e tillë.

Njëqind vjet më pas, kancelaritë europiane nuk varen prej letrave të gjata të konsujve për të kuptuar sa jemi evropianë, e as nga impresionet e mustaqokëve – gegë e toskë, priftërinj e shkrimtarë – por nga incizimet satelitore që tregojnë sasinë e drogës së kontrabanduar dhe përllogaritjet e thjeshta online që tregojnë se me çfarë shpejtësie marramendëse sunduesit e shtetit të ri në Europë arrijnë të vjedhin thesarin dhe çdo gjë publike, pos atyre që quhen shtëpi publike, që janë pjesë e feudeve të tyre.

Ndërkohë, Shqipëria dhe Kosova janë duke nisur një valë të re europianizimi. Në këmbë, duke kaluar një për një e njëqind për njëqind dhe një mijë për një mijë kufijtë e BE-së me shpresën imediate se në atë moment janë shndërruar në diasporë.

***Autori është themelues i Koha Ditore titulli origjinal: “Aspiratori i madh”**

Opinioni i Ditës

# Ja pse e takoi Donald Lu, Fatmir Xhafajn

Nga Spartak Ngjela

*(vijon nga faqja 1)*

... ishte një sfidë e hapur politikë kundrejt antiamerikanëve që janë të korruptuarit e elitës së lartë politike në Shqipëri.

Në kohën kur ambasadori amerikan takonte ministrin Xhafaj, në parlament korrupsioni fliste kundër ministrit. Qesharakë si këta nuk ka parë asnjë shtet i korruptuar deri më sot.

Amerikanët, në fakt, kanë kohë që tallen me këta të humbur që janë edhe steril nga mendja.

Nuk e kuptojnë dot faktin që politika është forcë; në një kohë kur Sali ziu e ka provuar njëherë këtë aspekt.

Por ekipit qesharak Berisha iu bashkua edhe Rama. Tjetër kaqol ky; sepse ky mendon të mundë Amerikën me Erdoganin, dhe dje u pa që interpretonte suret e Kuranit me sy nga Stambolli. Këta fakirë besoj se shpejt, në një të ardhme të afërt do të jenë personazhe nëpër komeditë shqiptare që do të shkruhen, se janë tema të gatshme.

Tani për këdo është e qartë që ministrin e Brendshëm Xhafaj po e mbështet politika amerikane. Dhe sigurisht që kjo ndodh se kuptohet që forca aktuale kundër korrupsionit të lartë në Shqipëri është një polici e fortë dhe e palëkundur. Xhafaj duket që ua ka garantuar këtë.

Takimi i djeshëm i tij me Donald Lu, me atë ngarkesë të thekshme politike kundër korrupsionit kryeministror shqiptar, e tregoi hapur këtë gjë.

"Analiza spektrale e zërit, për çështjen Babalja, ka dalë tani që është manipulim i manipulatorëve të Partisë Demokratike; dhe ne do ta godasim rëndë"- këtë kuptohet se ka thënë dje politika amerikane me anë të takimit që bëri ministri Xhafaj me ambasadorin Donald Lu; dhe sidomos me daljen publike dhe hipjen e Xhafaj në makinën e ambasadorit amerikan.

Mbrëmë në të gjitha televizionet antiamerikanët që përkrahin korrupsionin e lartë në Shqipëri, flisnin budallallëqe, jashtë artikulimit politik.

E gjithë kjo dha të kuptuar se nga reforma në drejtësi preken shumë sfera të aktivitetit politik dhe gazetaresk në Shqipëri.

Në të vërtetë Shqipëria sot është futur plotësisht në procesin e vet të purifikimit antikorrupsion.

Për këtë arsye, të korruptuarit e lartë nuk kanë më asnjë shpresë, kot tjerrin budallallëqe me argumente qesharake nëpër emisione televizive.

Kurse "çështja Babalja" pritet të shkojë shumë keq për Bashën dhe Berishën, se ka qenë, në fakt, një provokimi i rëndë kundrejt politikës amerikane, dhe kuptohet që FBI e ka hetuar plotësisht.



Në fakt, gjithçka ka marrë fund për korrupsionin kryeministror Rama-Berisha, por edhe për të gjithë bishtat e tyre në të gjitha sferat ku ka punuar politika e korruptuar: edhe në treg, por edhe në pushtetin gjyqësor, dhe, edhe në media. Sot gjithçka është e faktuar, prandaj ka siguri të plotë që purifikimi antikorrupsion në Shqipëri do të jetë i një spektri shumë të gjerë.

Ka një rregull që na ka mësuar historia në situata të tilla: kur një forcë madhore si Amerika merr përsipër reformën në një vend, me marrëveshje politike, ajo rregullon legjislacionin, pastron pushtetin gjyqësor dhe prokurorinë nga korrupsioni; dhe fillon goditjen penale të korrupsionit. Fiks kjo është metoda që amerikanët po përdorin edhe në Shqipëri: sistemimin e Kushtetutës dhe të legjislacionit, skartimin e korrupsionit në gjykatë dhe prokurori, dhe, në fund, akuzën penale kundër të gjithë korrupsionit kryeministror shqiptar.

Realisht kjo është edhe tabloja e zhvilluar në Shqipëri për antikorrupsionin.

Që Sot e tutje, kuptohet se, bashkë me "çështjen Babalja", mendoj se opinioni shqiptar do të vijojë të jetë në kontakt publikisht edhe me shumë fakte të tjerë.

Tani për këdo është e qartë që ministrin e Brendshëm Xhafaj po e mbështet politika amerikane. Dhe sigurisht që kjo ndodh se kuptohet që forca aktuale kundër korrupsionit të lartë në Shqipëri është një polici e fortë dhe e palëkundur. Xhafaj duket që ua ka garantuar këtë.

## HOROSKOPI

### DASHI

Nuk është e thjeshtë të ruash përqendrimin tek çështjet më urgjente, nëse nuk do t'ua ktheni me një "jo" strategjike atyre që do t'ju kërkojnë ndihmë. Përkushtojini më shumë kohë vetes dhe pasioneve që keni dhe shijoni gjërat e vogla që ju ofron jeta.

### DEMI

Keni nevojë për një ndryshim ambienti që ju rikthen entuziazmin ideve të reja që keni, për të mos humbur gjallërinë dhe entuziazmin që ju shquan nga të tjerët. Më në fund erdhi një ditë e qetë, pikërisht ajo që ju duhet për të qëndruar më shumë me të dashurit tuaj.

### BINJAKET

Fjalët e bukura dhe vështrimet e ëmbla nuk ju mjaftojnë? Mos kërkoni shumë nga partneri, nëse nuk doni të krijoni tensione pa arsye. Të kënaqeni është e rëndësishme, nëse doni të ndërtoni themelet mbi të cilat të ngrini një raport të qëndrueshëm.

### GAFORJA

Duke mos u dashur të zgjoheni herët për të shkuar në punë, mund rrini të qetë dhe të mos lodheni shumë. Keni nevojë për të pushuar pak. Por nëse bie alarmi i orës, pasi edhe sot ju thërret detyra, mendoni të pini një kafe të mirë dhe do të merrni zemër.

### LUANI

Të favorizuar nga Saturni, zgjidhja e një çështjeje që ju shqetësonte do të jetë e thjeshtë, sepse jeni të fortë nga besimi që ju japin shumë persona. Duke mundur të merrni nën kontroll situatën, do të keni çdo gjë nën vëzhgim dhe do të qëndroni vigjilentë.

### VIRGJERESHA

Keni zbuluar te personin e dashur një anë, ekzistencën e së cilës e keni shpërfillur? Nuk ka problem, do të shërbejë për ta bërë marrëdhënien tuaj në çift më të plotë. Gjatë kësaj periudhë jeni shumë të shpërqendruar, tregohuni të vëmendshëm, nëse do të angazhoheni në atë që bëni.

### PESHORJA

Hëna është në harmoni me Plutonin dhe Venusin, mund të keni më shumë vullnet për të përmirësuar fushën e ndjenjave dhe të dashurisë. Në shtëpi keni një atmosferë të qetë, duke qenë se dini si ta krijoni.

### AKREPI

Në vend që të rrini i ngulitur tek telefoni dhe rrjetet sociale, vendosni të dilni. Nëse doni, mund bëni një takim romantik, apo thjesht mund të argëtoheni pak. Raste do të keni, por ndoshta ju mungon perceptimi për t'i vënë në pah në kohën e duhur.

### SHIGJETARI

Pozicionimi i Hënës në lidhje me Plutonin bën që të jeni i pandalshëm përgjatë rrugës së ndërmarrë dhe nuk do të ndaloni edhe përpara të papriturave. Me ngadalë, por pashmangshmërisht, do të anashkaloni pengesën për të shkuar drejt qëllimit.

### BRICJAPI

Ndjenja juaj për drejtësi do t'ju ndihmojë të zgjidhni me shpejtësi një çështje delikate, në të cilën nuk do të kishit dashur fare të ishit përfshirë. Pak rëndësi ka nëse mënyra juaj e të vepruarit nuk arrin të kënaqë gjithkënd. Ai që ka rëndësi është integriteti juaj.

### UJORI

Të mbështetur nga Hëna, do të jetë e lehtë të shkoni mirë me partnerin tuaj, edhe pas një zënkë të vockël, sepse të grindeni nuk do të thotë se nuk duheni! Jeni gati të hapni rrugë për personin tuaj të zemrës, për ju dashuria vjen para çdo gjëje.

### PESHQIT

Po mendoni sesi ta bëni sa më të veçantë festën e ditëlindjes? Fillimisht mendoni për menynë dhe mbi të gjitha për tortën! Shpresoni të merrni një dhuratë të rëndësishme, por për të qenë të sigurt hidhjani si fjalë larg e larg të tjerëve.

VIKTIMAT E KOMUNIZMIT

# Kërkimi për të zhdukurit e komunizmit nis nga Mali me Gropa

Fatmira Nikolli

*Zbardhet marrëveshja mes qeverisë e Komisionit Ndërkombëtar, si do të gjenden të pushkatuarit*

*Hamz Kazazi skicon hartën e një vendvarrimi të fshehtë ku janë eshtrat e të pushkatuarve*

Tri ditë më parë, në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave u firmos marrëveshja mes qeverisë shqiptare dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (më tej: ICMP). Duke qenë se prej rënies së regjimit komunist familjarë të më shumë se 4000 të zhdukurve kërkojnë eshtrat e të afërmve, pritet që të nisë puna në terren, duke nisur fillimisht nga identifikimi i 13 mbetjeve njerëzore të gjetura 8 vite më parë në një varrezë masive në Dajt. Më pas, sipas të dhënave të siguruara ndër vite, do të kërkohen eshtra të tjera të pushkatuarisht gjatë regjimit, për të bërë të mundur mandej, identifikimin e tyre dhe dorëzimin e eshtrave tek familjarët.

Marrëveshja mes qeverisë dhe ICPM-së është iniciuar nga Genta Mara Sula vite më parë kur ajo ishte zëvendësministre e Çështjeve Sociale. Tani, kur ajo po finalizohet dhe Sula drejton Autoritetin e Dosjeve uron "ata që punuan për këtë standard të ri të mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, sidomos familjeve që nuk kanë reshtur kurrë përpjekjet për t'i nderuar njerëzisht personat e humbur".



Duket se Autoriteti i Dosjeve të ish-Sigurimit, do të ketë rol edhe për gjetjen e varreve të të zhdukurve. Pak ditë më parë, pranë Autoritetit, është paraqitur Hamz Kazazi. "Na tregoi me skicë e hartë për një vendvarrim të fshehtë, ku mund të gjenden eshtrat e të pushkatuarve nga diktatura komuniste. Këtë informacion të vyer do ta dërgojmë menjëherë tek IIPP dhe ICMP. Z. Hamz ende kërkon eshtrat e 7 pjesëtarëve të familjes së vet", shkruan Sula.

BE i ka dhënë ICMP rreth 450,000 euro për të nisur punën. Shuma do të përballojë kërkimin në dy vendvarrime ku besohet se prehen viktima të paidentifikuara, por ka edhe dhjetëra vendvarrime të tjera në vend. Gërmimi i parë do të bëhet në një varrezë sekrete në zonën e njohur si Baraka 313 në afërsi të Malit me gropa në Tiranë, ku mendohet se shumë njerëz janë ekzekutuar e varrosur, ndërsa pika e dytë do të jetë një zonë në Ballsh.

**MARRËVESHJA**

Marrëveshja mes qeverisë dhe ICMP-së përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj të fundit mbi gjetjen e të zhdukurve.

ICMP (Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur) do të ndërmarrë përpjekje për të asistuar autoritetet shqiptare në përpilimin e listës së personave që janë zhdukur dhe anëtarët e familjeve të tyre, duke përdorur Qendrën e Kërkimit Online të ICMP-së (OIC) dhe Sistemin e Menaxhimit të Identifikimit të të Dhënave (iDMS).

Ai do të sigurojë asistencë teknike në aspektin e arkeologjisë dhe antropologjisë mjeko-ligjore dhe do të sigurohet që familjet e personave të zhdukur të informohen rregullisht lidhur me përparimin në gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur.

Komisioni do të shpërndajë informacione në lidhje me procesin e kërkimit, rikuperimit dhe identifikimit për publikun, në konsultim me autoritetet shqiptare.

Ai do të kryejë vlerësime të nevojave për të përcaktuar kërkesat për gërmimin, rikuperimin dhe operacionet identifikuese në lidhje me personat e zhdukur. Nga ana tjetër, gjatë punës kërkimore, do të mbledhë të dhëna ante-mortem (para vdekjes) për personat e zhdukur dhe mostrat gjenetike referuese nga anëtarët e familjes në përputhje me politikat e saj të mbrojtjes së të dhënave. ICMP do t'i ofrojë Komisionerit Shqiptar për mbrojtjen e të dhënave kopjet e Politikat e ICMP-së mbi Përpunimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Politikën mbi Mbajtjen e të Dhënave, Të Dhëna dhe Prova Fizike dhe Politikën e ICMP-së mbi Konfidencialitetin.

Për identifikimin e eshtrave që gjenden, Komisioni do të kryejë testime të ADN-së së mostrave post-mortem të pranuara nga institucioni përgjegjës i Shqipërisë dhe të kërkojë që të përputhen profilet e ADN-së të marra prej tyre me mostrat e ADN-së të ofruara nga anëtarët e familjes së të zhdukurve në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit ICMP aktuale në kohën e testimit. Ai ka marrë përsipër të komunikojë në kohën e duhur, rezultatet e gjetjeve të saj me institucionin shqiptar përgjegjës për njerëzit e zhdukur, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Për çdo rast, Komisioni Ndërkombëtar i Personave të zhdukur do të dërgojë raportet e ADN-së në formatin e raportimit standard të ICMP-së tek institucioni Shqiptar përgjegjës për njerëzit e zhdukur, i cili pas marrjes së tyre, ua dërgon autoriteteve përgjegjëse gjyqësore dhe ekspertëve për kryerjen e identifikimeve ligjore dhe lëshimin e certifikatave të vdekjes dhe mundësimin e varrimit të denjë të mbetjeve mortore të të zhdukurve.

VIZITA

# Kumbaro kërkon Kosovën në UNESCO dhe Ermonela Jahon ambasadore

Është prezantuar zyrtarisht kandidatura e sopranos shqiptare me famë botërore, Ermonela Jaho, si Ambasadore e Vullnetit të Mirë në UNESCO. Propozimi është bërë nga ministrja e Kulturës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro, gjatë një takimi që ka pasur në Paris me drejtoreshën e Përgjithshme të UNESCO-s, Audrey Azoulay. Në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën Kumbaro tha se Ermonela Jaho ka shprehur gatishmërinë, për të vënë emrin, zërin dhe famën e saj në shërbim të kauzave dhe projekteve të UNESCO-s. Ajo theksoi se do të ishte në nderin e organizatës që të angazhojë një grua dhe një artiste të këtij niveli për të punuar e ndikuar që kultura të mbetet urë komunikimi mes të rinjve në mbarë botën dhe të luajë rolin që i takon në paqen dhe emancipimin e shoqërive në botë. UNESCO-Shqipëria, model i zhvillimit të trashëgimisë. Gjatë takimit mes Kumbaros dhe Audrey Azoulay-t, kjo e fundit sipas njoftimit zyrtar të MK-së ka vlerësuar modelin shqiptar të zhvillimit. "Vlerësojmë shkëlqyeshëm punën dhe rezultatet e Shqipërisë në mbrojtjen, konservimin, restaurimin dhe sensibilizimin e trashëgimisë, me synimin e qartë për t'i dhënë zhvillim turizmit kulturor, përmes politikave të qarta në trashëgiminë kulturore. UNESCO vlerëson modelin shqiptar të zhvillimit, duke theksuar se ai duhet treguar për të gjithë rajonin", - u shpreh drejtoresha e Përgjithshme e UNESCO-s, Audrey Azoulay në takimin e zhvilluar me ministren e Kulturës, Mirela Kumbaro. Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro ka kërkuar edhe anëtarësimin e Kosovës në UNESCO. Gjatë takimit të saj me drejtoreshën Audrey Azoulay, Kumbaro prezantoi punën e trashëgimisë në sitet botërore të mbrojtura nga UNESCO në Shqipëri, Butrint, Berat dhe Gjirokastër, duke vënë theksin në angazhimin e qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Kulturës për të bërë bashkë ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin ekonomik. "Hapat e Shqipërisë në këtë drejtim janë të dukshme, mjaft të shohim suksesin e Rilindjes Urbane, shifrat e vizitorëve, vendas dhe të huaj, shtimin e strukturave akomoduese në qendrat e trashëgimisë kulturore, për të kuptuar se synimi i kësaj qeverie është politika e bashkëpunimit mes shtetit, privatit dhe partnerëve tanë të rëndësishëm si Banka Botërore, Bashkimi Europian, apo Fondi Shqiptaro- Amerikan i Zhvillimit", tha Kumbaro. Më tej gjatë bisedës, ministrja Kumbaro preku edhe çështjen e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, duke vënë theksin se ajo duhet parë si një temë e kulturës universale, e ndarë nga politika dhe garantoi përpjekjet e qeverisë shqiptare për të forcuar dhe zgjeruar bashkëpunimin rajonal dhe rolin emancipues të kulturës në këtë drejtim. "Ne mbështesim kontributin kulturor të Kosovës, krahas të gjitha vendeve të tjera, në UNESCO, si në një familje të madhe kulturore ku secili është pjesë e mozaikut të kësaj hapësire pa kufi, ku sidomos të rinjtë duhet të jenë prioritet, - theksoi Kumbaro. - Kjo nuk duhet parë si akt politik për të sfiduar ndokënd, por vetëm si nevojë e natyrshme për t'i dhënë kulturës, arsimit, shkencës dhe rinisë në Kosovë të njëjtat mundësi për bashkëpunim dhe ndërveprim si në vendet e tjera të rajonit dhe botës". Në ditët e qëndrimit në Paris, Kumbaro zhvilloi një takim pune me Metchtild Rossler, drejtoreshë e Qendrës së Trashëgimisë Botërore në UNESCO, ku u diskutua për zhvillimet pozitive në fushën e trashëgimisë në dy qytetet Gjirokastër dhe Berat dhe në Parkun e Butrintit. "Jo vetëm keni plotësuar kërkesat e UNESCO-s, por njëkohësisht jeni një nga shembujt pozitivë të modelit të zhvillimit, që përkon me synimet e kësaj organizate, që synon ruajtje, mbrojtje, sensibilizim dhe zhvillim të trashëgimisë botërore", u shpreh ajo.



Mirela Kumbaro dhe Audrey Azoulay


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
GSH.AL
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GSH
www.gsh.al
Tashmë edhe lundroni!
GAZETA SHQIPTARE
KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA
Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullet me Fatos Nanon
Sherri për kafshët, Roza Lati: Do t'i jap kastravecë
BLUE TOOTH
500 NUMRA, NJE HISTORI SUKSESI
SUMMER
DORINA GEGIÇI
Çdo profesion ka nevojë për talent, jo sponsor
A e meriton Shën Tereza një muze në Shqipëri?!